



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 60

Tiranë – E hënë, 18 prill 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 682/4, datë 1.4.2016	
Për aktivitetin e autoshkollave, pajisjen e kandidatëve me lejedrejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave dhe specialistëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).....	3687



UDHËZIM

Nr. 682/4, datë 1.4.2016

**PËR AKTIVITETIN E AUTOSHKOLLAVE,
PAJISJEN E KANDIDATËVE ME
LEJEDREJTIMI, KUALIFIKIMIN E
INSTRUKTORËVE TË
AUTOSHKOLLAVE DHE
SPECIALISTËVE TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR (DPSHTRR)¹**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 119, 120 dhe 121 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 310, 311 dhe 313, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Udhëzimi ka si qëllim të rregullojë veprimtarinë e autoshkollave si subjekte të përgatitjes së drejtuesve të mjeteve, pajisjen e kandidatëve me lejedrejtimi, kualifikimin e instruktorëve të autoshkollave, kualifikimin e specialistëve të DPSHTRR-së dhe synon të përafrojë plotësisht direktivën 2006/126/KE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 dhjetor 2006, “Mbi lejet e drejtimit”.

PJESA I

**MBI AKTIVITETIN E AUTOSHKOLLAVE
PËR PËRGATITJEN E KANDIDATËVE PËR
DREJTUES MJETI DHE PAJISJEN E TYRE
ME LEJEDREJTIMI**

Neni 2

Kushtet e veprimtarisë

1. Subjektet autoshkollë, për t'u pajisur me licencë, duhet të plotësojnë kriteret teknike dhe profesionale të përcaktuara në nenin 121 të Kodit Rrugor, të ndryshuar, nenin 313 të Rregullores në

zbatim të Kodit Rrugor, si dhe përcaktimeve të bëra në këtë udhëzim.

2. Autoshkollat zhvillojnë veprimtari mësimore, edukuese dhe instruktuese për formimin e drejtuesve të mjeteve me motor, sipas përcaktimeve të licencës.

Neni 3

Ambientet e autoshkollës

Autoshkolla duhet të ketë:

a) një klasë me ambient të mjaftueshëm dhe funksional me kapacitet jo më pak se 20 vende, të ndarë nga zyrat e tjera ose nga zyra e pritjes së publikut. Klasa duhet të ketë ndriçim dhe ventilim të mjaftueshëm, si dhe mjetet e nevojshme për mbrojtjen nga zjarri (MNZ);

b) ambient hidrosanitar sipas rregullave në fuqi dhe me ujë të vazhdueshëm, brenda ambientit të autoshkollës.

Sipërfaqet e të gjitha ambienteve (klasa, zyra e pritjes së publikut, ambienti hidrosanitar) nuk duhet të jenë më pak se 30m².

Neni 4

Pajisjet mësimore

Pajisjet e klasës së mësimdhënies, minimalisht, duhet të përfshijnë:

a) një tavolinë për mësuesin e teorisë;

b) një tabelë shkrimi, prej dërrase ose xhami, me përmasa minimale 1.1m x 0.8 m;

c) tavolina dhe ndenjësë të përshtatshme të vendosura në distancë të përshtatshme;

d) të paktën 5 kompjuterë për kandidatët për prova testimi dhe projektor.

Neni 5

Materialet didaktike për mësimet e teorisë

Materialet didaktike për mësimin e teorisë përfshijnë:

a) një seri tabelash me sinjalet rrugore (sinjalet vertikale, sinjalet horizontale sinjalet e ndritshme dhe sinjalet e policëve të trafikut);

b) tabela mbi sjelljen në rast aksidentesh, si dhe qëndrimi e masat që duhen marrë në këto raste;

c) maket elektrik i ndriçuar, për motor dhe automjet;

d) një vend të përshtatshëm ku të vendoset një sedilje me rripa sigurimi dhe kaska mbrojtëse që shërbejnë për të treguar funksionimin e tyre;

¹ Udhëzimi synon përputhshmëri të plotë me direktivën nr. Celex 320060126, 2006/126/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 20 dhjetorit 2006, mbi lejet e drejtimit.



e) një vend të përshtatshëm ku të vendosen pajisje që shërbejnë për zvogëlimin e ndotjes mjedisore;

f) një vend të përshtatshëm ku të vendoset kutia e ndihmës së shpejtë;

g) tabela të përshtatshme për njohjen e mallrave dhe ngarkesave të rrezikshme;

h) maket automjeti ku të tregohen sistemet kryesore të motorit (sistemi i ftohjes, i lubrifikimit, i ndezjes, i ushqimit), sistemi i drejtimit, sistemi i frenimit, amortizatorët, struktura e karrocërisë. Për rastet kur maketi është i pakompletuar me sistemet dhe elementet e mësipërme atëherë këto duhet të tregohen me tabela;

i) tabela shpjeguese për lidhjen e rimorkiove dhe pjesët e frenimit të rimorkiove.

2. Materiali didaktik i përmendur në pikën 1, gërmat “b”, “c”, “d”, “f”, “g” dhe “h” mund të zëvendësohet me pajisje audiovizive ose multimediale të përshtatshme, të miratuara nga DPSHTRR-ja.

Neni 6

Mjetet për ushtrimin e praktikës

1. Mjetet për ushtrimin e praktikës përfshijnë mjetet e nevojshme për pajisjen me lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, A, B1, B, BE, C1, C1E, C, CE, D1, D1E, D dhe DE.

2. Për rastet kur kandidati kërkon të pajiset me lejedrejtimi, me kuti shpejtësie automatike, mjeti për ushtrimin e praktikës duhet të jetë me kuti shpejtësie automatike.

3. Mjetet rrugore mësimore, me kuti shpejtësie manuale, përveç atyre të kategorisë “A1, A2 dhe A”, duhet të jenë të pajisura me pedale të dyfishta (gaz, friksion, frena), ndërsa mjetet rrugore mësimore me kuti shpejtësie automatike, përveç atyre të kategorisë “A1, A2 dhe A”, duhet të jenë të pajisura me pedale të dyfishta për gaz dhe frena. Pedalet e dyfishta dhe hapësira ndërmjet instruktorit e drejtuesit të mjetit duhet të jenë të përshtatshme, me qëllim që të mundësojnë ndërhyrjet e instruktorit në drejtimin e mjetit rrugor. Mjetet rrugore mësimore duhet të jenë me pamje të jashtme të rregullt dhe në gjendje të mirë teknike.

4. Mjetet për ushtrimin e praktikës janë pronë e autoshkollës dhe të miratuara me autorizim të veçantë nga DRSHTTR-ja.

5. Autoshkolla mund të ketë edhe mjete të

përshtatshme për marrjen e lejedrejtitimit të kategorisë B, me kodin e harmonizuar 96.

6. Mjetet duhet të jenë të pajisura me shenjën dalluese “AUTOSHKOLLA”, sipas nenit 312 të Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor. Në pjesët anësore të mjetit të shkruhen fjalët: autoshkolla dhe emri i subjektit, sipas përcaktimit të nenit 56, pika 3/c dhe “ç”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, i ndryshuar. Përmasa dhe lloji i shkrimit janë sipas figurës IV.1, neni 312 dhe figurës IV.2, neni 312 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000.

7. Çdo ndryshim destinacioni dhe pronësie të mjetit autoshkollë të pasqyrohet menjëherë në sistemin informatik në sektorin përgjegjës të autoshkollave të DPSHTRR-së.

Neni 7

Dokumentet që administrohen nga autoshkolla

Dokumentet që administrohen nga autoshkolla, janë:

1. Licenca e veprimtarisë për autoshkollë, të marrë nga QKL-ja;

2. Dokumenti i identifikimit të titullarit të licencës dhe i drejtuesit teknik;

3. Rregullorja për funksionimin e autoshkollës ku janë përcaktuar:

- orari ditor dhe ditët e veprimtarisë;
- orët e zhvillimit të seanceve të teorisë dhe të praktikës;

- detyrat dhe të drejtat e personelit;

- detyrat dhe të drejtat e kandidatit;

- kushtet e marrëveshjes me kandidatin dhe përcaktimi i tarifave të shërbimit;

4. Leje për ushtrimin e aktivitetit për përgatitjen e kandidatëve për drejtues mjeti, lëshuar nga Drejtoria Rajonale;

5. Autorizim mjeti për ushtrim praktikë dhe marrje në prova, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale;

6. Dëshmitë e aftësive profesionale për mësuesit e teorisë dhe të instruktorit të praktikës dhe dokumentet e identifikimit të tyre;

7. Autorizim për instruktorin e praktikës të lëshuar nga Drejtoria Rajonale;

8. Kontratat e punësimit (të lidhur midis titullarit të licencës dhe personelit);

9. Leja e përgatitjes teorike (model DD/T) dhe autorizimi i praktikës të kandidatit (model DD/P), sipas modeleve të DPSHTRR-së;



10. Regjistri i kandidatëve për drejtues mjetei (amza) sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

11. Regjistri i zhvillimit të mësimit të teorisë sipas modeleve të hartuar nga DPSHTRR-ja. Regjistri plotësohet nga mësuesi i teorisë;

12. Regjistri i zhvillimit të mësimit të praktikës sipas modeleve të hartuar nga DPSHTRR-ja. Regjistri plotësohet nga instruktori i praktikës;

13. Dokumentet ligjore të pronësisë ose të marrjes me qira të ambientit të autoshkollës, shoqëruar me planimetrinë e klasës, pjesë e dokumentacionit ligjor të pronësisë;

14. Dokumentet ligjore të mjeteve (leje-qarkullimi, siguracioni, kontrolli teknik);

15. Kontrata e lidhur ndërmjet titullarit të autoshkollës dhe kandidatit, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrat e secilës palë.

Kandidati ka të drejtë të anulojë kontratën në rast se autoshkolla nuk e pajis atë me leje për kursin e teorisë apo me autorizimin për ushtrimin e praktikës, brenda 10 ditëve, nga data e kërkesës ose nga data e fitimit të provimit të teorisë.

Në rastin e anulimit të kontratës me autoshkollën apo me kërkesën e njëjës prej palëve, kandidati mund të regjistrohet në një autoshkollë tjetër.

Neni 8

Regjistrimi i autoshkollës në DRSHTRR

Me dorëzimin e dokumenteve nga autoshkolla, DRSHTRR-ja bën verifikimin nëse autoshkolla plotëson kriteret teknike dhe profesionale për të ushtruar veprimtarinë sipas përcaktimeve të licencës. Verifikimi bëhet nga një komision me kryetar drejtorin e Drejtorisë Rajonale dhe dy anëtarë të tjerë inxhinierë mekanikë, brenda 30 ditëve.

Në përfundim, komisioni harton procesverbalin e verifikimit ku përcaktohet plotësimi i kriterëve teknike dhe profesionale. Në qoftë se autoshkolla nuk plotëson kriteret teknike dhe profesionale sipas licencës për një kategori të caktuar, atëherë kjo kategori nuk regjistrohet në sistemin e të dhënave të autoshkollave në DPSHTRR. Mbi bazën e licencës dhe të procesverbalit “Mbi verifikimin e kushteve për autoshkollë” lëshohet nga drejtori i Drejtorisë Rajonale, “Leje për ushtrim aktiviteti”.

Neni 9

Vendndodhja dhe transferimi

Autoshkolla duhet të afishojë në selinë e saj, ditët dhe orët e punës për mësimet teorike dhe praktike.

Ndryshimi i vendndodhjes së autoshkollës bëhet duke paraqitur kërkesë me shkrim pranë QKR-së, QKL-së dhe DRSHTRR-së, 30 ditë përpara se të bëhet transferimi. Ndryshimi i vendndodhjes së autoshkollës bëhet sipas ndryshimeve që bëhen në licencën e zhvillimit të veprimtarisë në QKR dhe QKL.

Titullari ose drejtuesi teknik i autoshkollës duhet të informojë Drejtorinë Rajonale për çdo ndryshim të vendndodhjes të autoshkollës.

Në rast ndryshimi të vendndodhjes së aktivitetit të autoshkollës pa bërë ndryshimet në QKR dhe QKL dhe pa u verifikuar nga DRSHTRR-ja aktiviteti i autoshkollës pezullohet për një periudhë nga një deri në tre muaj.

Neni 10

Mësuesit e teorisë dhe instruktorët e praktikës

1. Autoshkolla duhet të ketë të paktën një mësues teorie dhe të paktën një instruktor për ushtrimin e praktikës.

2. Mësuesit e teorisë duhet të jenë të pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale.

3. Instruktorët e praktikës duhet të jenë të pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale për lejedrejtimi dhe kur përgatit kandidatë për CAP-in duhet të ketë edhe certifikatën e aftësisë profesionale (CAP), në varësi të kandidatëve që përgatit.

Neni 11

Regjistrimi i kandidatëve për lejedrejtimi

Regjistrimi i personave të interesuar për t'u pajisur me lejedrejtimi bëhet në autoshkolla.

Para lëshimit të lejes apo autorizimit bëhet pagesa përkatëse sipas kategorisë së lejedrejtimit. Pagesa mund të bëhet në një bankë të nivelit të dytë ose pranë zyrave përkatëse të DRSHTRR-së.

Data regjistrimi është data e pajisjes me “LEJE” për përgatitjen e njohurive teorike ose “AUTORIZIM” për përgatitjen e aftësive drejtuese e të sjelljes.

1. Regjistrimi i kandidatit për zhvillimin e kursit të teorisë



Zyra përkatëse e DRSHTRR-së, pas dorëzimit të dokumenteve të përcaktuara në nenin 311, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, miraton regjistrimin e kandidatit në kursin e përgatitjes teorike pasi shqyrton plotësimin e kriterëve si më poshtë:

- *Për kandidatin*

a) të plotësojë kërkesat e moshës minimale dhe maksimale, në varësi të kategorisë së lejedrejtimit siç përcaktohet në lidhjen 1 të këtij udhëzimi dhe dispozitat e Kodit Rrugor për moshën maksimale;

b) të mos ketë vendim të autoriteteve kompetente, për ndalim pajisje të kandidatit me lejedrejtimi;

c) të jetë i pajisur me kategorinë e duhur të lejedrejtimit që mundëson kalimin në kategorinë e lejedrejtimit që kërkohet siç parashikohet në lidhjen 2 të këtij udhëzimi;

d) të mos jetë në proces përgatitje teorike për kategori tjetër;

e) të mos jetë në proces përgatitje praktike për asnjë kategori tjetër, përveç kategorisë A1, A2 dhe A;

f) të ketë minimalisht një pikë nga gjendja e pikëve, si dhe të mos ketë lejedrejtimi të hequr.

- *Për autoshkollën*

a) të ketë licencë të vlefshme për kategorinë që kërkohet;

b) të ketë drejtues teknik me kontratë pune të vlefshme (data e përfundimit të kontratës të jetë më e vonshme se data kur bëhet regjistrimi);

c) të ketë mësues teorie (mësuesi i teorisë mund të jetë njëkohësisht dhe drejtues teknik), si dhe të jetë:

- i punësuar me kontratë pune të vlefshme (data e përfundimit të kontratës të jetë më e vonshme se data kur bëhet regjistrimi);

- me dëshmi aftësie profesionale, të vlefshme.

Në rast se kontrata e punës përfundon brenda periudhës së zhvillimit të kursit të teorisë, autoshkolla duhet të marrë masat e duhura për mosndërprerje të procesit mësimor.

Këto kushte duhet të jenë të vlefshme për çdo ditë përgatitje të kandidatit.

Për çdo ndryshim, përfaqësuesi ligjor i autoshkollës, duhet të njoftojë me shkrim DRSHTRR-në për marrjen e masave të nevojshme.

Në përfundim të këtij miratimi, DRSHTRR-ja

lëshon “LEJE” (modeli DD/T) të vlefshme për provën e teorisë për 6 muaj nga data e lëshimit të lejes.

2. Regjistrimi i kandidatit për zhvillimin e kursit të praktikës

DRSHTRR-ja lëshon autorizimin e praktikës së kandidatit, me kërkesë të autoshkollës. Kërkesa mund të bëhet me shkrim ose në rrugë elektronike.

Autorizimi lëshohet pasi shqyrtohet plotësimi i kriterëve si më poshtë:

- *Për kandidatin*

a) të ketë teori të vlefshme ose të ketë dorëzuar dokumentet e nevojshme sikurse përcaktohet në nenin 311, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

b) të plotësojë kërkesat e moshës minimale dhe maksimale, në varësi të kategorisë së lejedrejtimit, siç përcaktohet në lidhjen 1 të këtij udhëzimi dhe dispozitat e Kodit Rrugor për moshën maksimale;

c) të mos ketë vendim të autoriteteve kompetente, për ndalim pajisje të kandidatit me lejedrejtimi;

d) të jetë i pajisur me lejedrejtimin e duhur që mundëson kalimin në kategorinë e lejedrejtimit që kërkohet siç parashikohet në lidhjen 2 të këtij udhëzimi;

e) të mos jetë në proces përgatitje praktike për kategori tjetër;

f) të ketë minimalisht një pikë nga gjendja e pikëve, si dhe të mos ketë lejedrejtimi të hequr.

- *Për autoshkollën*

a) të ketë licencë të vlefshme për kategorinë që kërkohet;

b) të ketë drejtues teknik me kontratë pune të vlefshme (data e përfundimit të kontratës të jetë më e vonshme se data kur bëhet regjistrimi);

c) të ketë instruktor praktike:

- i punësuar me kontratë pune të vlefshme;

- me dëshmi të vlefshme si “instruktor praktike” për kategorinë përkatëse;

- me lejedrejtimi të vlefshme për kategorinë përkatëse;

- me jo më shumë se 12 kandidatë në ditë;

- me autorizim për ushtrim praktike për autoshkollën.

Data e përfundimit të vlefshmërisë të këtyre dokumenteve të jetë më e vonshme se data kur



bëhet regjistrimi në praktikë.

Instruktori i praktikës duhet të jetë jo më i madh se 65 vjeç dhe jo më i vogël se 30 vjeç, i pajisur me lejedrejtimi të vlefshme për të njëjtën kategori mjeti, të marrë të paktën prej 10 vjetësh, ose lejedrejtimi të vlefshme për një kategori më të lartë.

Një instruktor praktike mund të përdorë çdo mjet të autoshkollës, sipas kategorisë përkatëse që disponon instruktori, por nuk mund të punojë në dy autoshkolla të ndryshme njëkohësisht.

d) të ketë një mjet praktike të kategorisë përkatëse:

- me autorizim të vlefshëm si mjet autoshkolle i kategorisë përkatëse;
- me siguracion të vlefshëm;
- me kontroll teknik të vlefshëm.

Me një mjet autoshkolle nuk mund të ushtrohen në praktikë më shumë se 12 kandidatë në ditë.

Me kërkesë të drejtuesit teknik të autoshkollës, DRSHTRR-ja miraton ndryshimin e instruktorit të praktikës apo të mjetit me të cilin përgatitet kandidati, me kusht që të plotësohen kërkesat e pikës “c” dhe “d” të këtij neni.

Këto kushte duhet të jenë të vlefshme për çdo ditë përgatitje të kandidatit.

Autoshkolla duhet të ketë të paktën 1 mjet për çdo kategori lejedrejtimi për të cilat është licencuar.

Në rast se vlefshmëria e ndonjë prej dokumenteve të mësipërme përfundon brenda periudhës së zhvillimit të kursit të praktikës, autoshkolla duhet të marrë masat e duhura për mosndërprerje të procesit mësimor.

Me përfundimin e regjistrimit të kandidatit në praktikë, DRSHTRR-ja lëshon autorizimin përkatës (model DD/P).

Autorizimet DL/P të miratuara nga DPSHTRR-ja, janë:

- DD/P (A1, A2, A) për lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, A;
- DD/P (B1, B, B96, BE) për lejedrejtimi të kategorisë B1, B, BE;
- DD/P (C1, C1E, C, CE) për lejedrejtimi të kategorisë C1, C1E, C, CE;
- DD/P (D1, D1E, D, DE) për lejedrejtimi të kategorisë D1, D1E, D, DE.

Neni 12

Regjistrimi i kandidatëve me nënshtetësi të huaj

1. Të gjithë personat e interesuar, që nuk janë shtetas shqiptarë, mund të pajisen me lejedrejtimi të mjetit, pasi të paraqesin dokumentet e përcaktuara në nenin 311, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, të ndryshuar.

2. Rregullat e përgatitjes dhe të provave për të marrë lejedrejtimi mjeti për këta persona janë të njëjta si për shtetasit shqiptarë.

3. Në provën e kontrollit të njohurive teorike dhe në provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, për pajisje me lejedrejtimi mjeti, personi i interesuar ka të drejtë të marrë dhe përkthyes të licencuar ose me diplomën përkatëse. Në rast se testi teorik zhvillohet në gjuhë të huaj nuk duhet përkthyes.

Neni 13

Transferimi i regjistrimit të kandidatëve

Procedurat që ndiqen për kandidatët për drejtues mjeti kur ata transferohen nga një autoshkolle në një tjetër kur aktiviteti i të parës është pezulluar ose ndërprerë, si dhe në rastet e prishjes së kontratës midis kandidatit dhe autoshkollës ose me kërkesë të kandidatit, pasi të jetë njoftuar autoshkolla nga DRSHTRR-ja, janë si më poshtë:

1. Në rastin kur kandidatët e regjistruar për “Provat e kontrollit të njohurive teorike”, nuk e kanë përfunduar ciklin e plotë të përgatitjes teorike, lejet ekzistuese, model DD/T, anulohen dhe kandidatët pajisen me leje të reja, model DD/T sipas regjistrimeve të autoshkollës tjetër dhe do të fillojnë kursin e përgatitjes teorike në autoshkolle tjetër, nga e para. Certifikata mjekësore e kandidatit duhet të jetë e vlefshme.

2. Në rastin kur kandidatët e regjistruar në autoshkolle kanë kryer ciklin e plotë të përgatitjes teorike dhe nuk janë marrë në prova ose janë marrë në prova dhe nuk kanë fituar provën e teorisë, kandidatët do të vazhdojnë serinë e provave të teorisë, të pakryera.

3. Në rastin kur kandidatët e regjistruar në autoshkolle janë shpallur “Fitues” në “Provat e kontrollit të njohurive teorike” ose janë regjistruar dhe nuk e kanë përfunduar ciklin e plotë të përgatitjes praktike, autorizimet ekzistuese, model



DD/P anulohen, dhe kandidatët pajisen me autorizime të reja, model DD/P sipas regjistrimeve të autoshkollës tjetër dhe do të fillojnë kursin e përgatitjes praktike nga e para.

4. Në rastin kur kandidatët e regjistruar në autoshkollë kanë kryer ciklin e plotë të përgatitjes praktike dhe nuk janë marrë në prova për verifikimin e aftësive të sjelljes ose janë marrë në prova dhe nuk kanë fituar, kandidatët do të vazhdojnë serinë e provave për verifikimin e aftësive drejtuese e të sjelljes, të pakryera.

Lejet dhe autorizimet e reja që lëshohen pas anulimit të lejeve apo autorizimeve të vjetra lëshohen pas kryerjes së pagesave përkatëse.

Pagesat për regjistrimet e mëparshme nuk kthehen.

Neni 14

Kategoritë e lejedrejtimit, moshat minimale të kandidatëve dhe kërkesat për regjistrim për marrjen e kategorive të lejedrejtimit

Kategoritë e lejedrejtimit dhe moshat minimale për regjistrim për marrjen e tyre jepen në lidhjen 1 të këtij udhëzimi.

1. Mosha minimale për lejedrejtimi të kategorisë AM është 16 vjeç.

2. Mosha minimale për lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, B1, B është 18 vjeç.

3. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë A, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë A2, prej të paktën 2 vjet.

4. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë BE, ose B me kodin 96, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë B, prej të paktën 1 vit.

5. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë C1, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë B, prej të paktën 1 vit.

6. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë C1E, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë C1, prej të paktën 1 vit.

7. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë C, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë B, prej të paktën 3 vjet.

8. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë CE, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë C, prej të paktën 1 vit.

9. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë D1, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë C, prej të paktën 1 vit.

10. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë D1E, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë D1, prej të paktën 1 vit.

11. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë D, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë C, prej të paktën 3 vjet.

12. Për të marrë lejedrejtimi të kategorisë DE, kandidati duhet të ketë lejedrejtimi të kategorisë D prej të paktën 1 vit.

Neni 15

Marrja e lejedrejtimit dhe kalimi nga një lejedrejtimi në një lejedrejtimi të një kategorie tjetër

Kalimi nga një lejedrejtimi ekzistuese në një lejedrejtimi të një kategorie tjetër jepet në lidhjen 2.

1. Lejedrejtimet e kategorive A1, A2, B1, B mund të merren pa pasur lejedrejtimi ose nga kategoria AM me provë teorie dhe provë praktike.

2. Lejedrejtimi i kategorisë A2 mund të merret nga drejtuesit e mjeteve që janë mbajtës të lejedrejtimit të kategorisë A1, me provë praktike.

3. Lejedrejtimi i kategorisë A merret nga drejtuesit e mjeteve që janë mbajtës të lejedrejtimit të kategorisë A2, me provë praktike.

4. Lejedrejtimi i kategorisë B mund të merret nga drejtuesit e mjeteve që janë mbajtës të lejedrejtimit të kategorisë A1, A2, A ose B1, me provë praktike.

5. Lejedrejtimet e kategorisë A1, A2 mund të merren nga drejtuesit e mjeteve që janë mbajtës të kategorisë B me provë praktike.

6. Lejedrejtimi e kategorisë BE ose B me kodin 96 merret nga drejtuesit e mjeteve që janë mbajtës të lejedrejtimit të kategorisë B me provë praktike.

7. Lejedrejtimet e kategorisë C1 ose C merren nga drejtuesit e mjeteve që janë mbajtës të kategorisë B me provë teorie dhe provë praktike.

8. Lejedrejtimi e kategorisë C mund të merret nga drejtuesit e mjeteve që janë mbajtës të lejedrejtimit të kategorisë C1, me provë praktike.

9. Lejedrejtimet e kategorisë D1 ose D mund të merren vetëm nga drejtuesit e mjeteve që janë mbajtës të lejedrejtimit të kategorisë C, me prova teorie dhe praktike.

10. Lejedrejtimi e kategorisë D mund të merret nga drejtuesit e mjeteve që janë mbajtës të lejedrejtimit të kategorisë D1, me prova praktike.

11. Lejedrejtimet e kategorisë C1E, CE, D1E ose DE mund të merren vetëm nga drejtuesit që



janë mbajtes të lejedrejtmeve të kategorive respektive C1, C, D1 ose D, me provë praktike.

12. Mbajtesit e lejedrejtimit të kategorisë CE përfitojnë lejedrejtimin e kategorisë DE në momentin që pajisen me lejedrejtimi të kategorisë D. Ky fakt pasqyrohet në lejedrejtimi.

Neni 16

Lejedrejtimi për mjetet me kuti shpejtësie automatike

1. Marrja e lejedrejtimit për mjetet me kuti shpejtësie automatike bëhet nëpërmjet provës praktike me mjete me kuti shpejtësie automatike dhe lejon vetëm drejtimin e mjeteve të pajisura me kuti shpejtësie automatike. Në lejedrejtimin e marrë, përbri kategorisë, shënohet kodi 78, sipas kodeve të harmonizuara të BE-së.

2. Kalimi nga një kategori lejedrejtimi me kodin 78 në një kategori lejedrejtimi me kuti shpejtësie manuale, brenda së njëjtës kategori, bëhet në autoshollë me anë të kursit të përgatitjes praktike dhe provës praktike.

3. Me fitimin e njëres nga kategoritë e lejedrejtimit A1, A2, A, me kuti shpejtësie manuale, automatikisht, lejedrejtimet edhe për dy kategoritë e tjera bëhen lejedrejtimi mjeti me kuti shpejtësie manuale;

4. Drejtuesi i mjetit që zotëron njëren nga kategoritë B, C, D apo nënkategoritë e tyre të pajisur me kodin 78, kur fiton njëren nga kategoritë apo nënkategoritë me kuti shpejtësie manuale, ka të drejtën e drejtimit të mjeteve me kuti shpejtësie manuale për kategoritë apo nënkategoritë përkatëse dhe të atyre më të ulëta.

Neni 17

Njëvlefshmëritë e kategorive të lejedrejtimit

1. Të gjitha kategoritë e lejedrejtimit janë të vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë AM.

2. Lejedrejtimi i kategorisë A2 është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1.

3. Lejedrejtimi i kategorisë A është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1 dhe A2.

4. Lejedrejtimi i kategorisë B është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë B1, për të drejtuar motomjete me tri rrota simetrike ndaj aksit gjatësor me fuqi më të madhe se 15 kw, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtesit i lejedrejtimit të jetë të paktën 21 vjeç.

5. Lejedrejtimi i kategorisë BE ose B, me kodin 96, është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorisë B.

6. Lejedrejtimi i kategorisë C është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorive C1 dhe B.

7. Lejedrejtimi i kategorisë D është e vlefshme për drejtimin e mjeteve të kategorive D1, C dhe B.

8. Lejedrejtimi i kategorisë CE është e vlefshme për drejtimin e komplekseve të mjeteve të kategorive C1E dhe BE.

9. Lejedrejtimi i kategorisë CE është e vlefshme për drejtimin e komplekseve të mjeteve të kategorisë DE me kusht që personi të jetë i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë D.

10. Lejedrejtimi i kategorisë DE është e vlefshme për drejtimin e komplekseve të mjeteve të kategorive D1E, CE, C1E dhe BE.

11. Lejedrejtimi i kategorive C1E, CE, D1E, ose DE është e vlefshme për drejtimin e komplekseve të mjeteve për kategorinë BE.

12. Çdo kategori lejedrejtimi mjeti me kuti shpejtësie manuale është e vlefshme për të njëjtën kategori lejedrejtimi me kuti shpejtësie automatike, e kundërta jo.

Neni 18

Programi i përgatitjes teorike dhe kohëzgjatja e nevojshme

Programi i përgatitjes dhe provimit të teorisë jepen në lidhjen 3.

1. Programi i përgatitjes dhe provimit të teorisë është si më poshtë:

a) për lejedrejtimi të kategorisë AM - 10 tema;

b) për lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, B1 dhe B - 25 tema;

c) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë AM në lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, B1, B – 25 tema;

d) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B në lejedrejtimi të kategorisë C1, C - 17 tema;

e) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë C në lejedrejtimi të kategorisë D1, D - 2 tema.

Programi i përgatitjes së teorisë për lejedrejtimin e kategorisë A1, A2, B1 dhe B është i njëjtë. Për çdo kalim ndërmjet këtyre kategorive, nga njëra kategori në tjetrën, nuk zhvillohet përgatitje teorike dhe provim teorie.

Kur kandidati aplikon për një kategori më të lartë, nuk testohet për njohuritë e dhëna në provimet për kategoritë e marra më parë.



2. Kohëzgjatja e nevojshme për përgatitjen e njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti është si më poshtë:

a) Për lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, B, B1-36 orë, në jo më pak se 15 ditë kalendarike.

Për rastet e marrjes së kategorisë A1, A2, B1, B nga kategoria AM programi për përgatitjen e njohurive teorike është 26 orë, në jo më pak se 8 ditë kalendarike;

b) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B në lejedrejtimi të kategorisë C1, C – 20 orë, në jo më pak se 10 ditë;

c) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë C në lejedrejtimi të kategorisë D1, D – 4 orë, në jo më pak se 3 ditë.

Programi i përgatitjes teorike, kohëzgjatja e nevojshme dhe provimet për marrjen e lejedrejtimit të mjeteve me kuti shpejtësie automatike (kodi 78) është i njëjtë me ato të lejedrejtimit të mjeteve me kuti shpejtësie manuale për kategoritë përkatëse.

Neni 19

Programi i përgatitjes së aftësive drejtuese e të sjelljes dhe kohëzgjatja e nevojshme

Programi për përgatitjen e kandidatëve për aftësimin e drejtimit dhe të sjelljes, kohëzgjatja e nevojshme dhe provimi jepet në lidhjen 4.

1. Kohëzgjatja, për përgatitjen e aftësive drejtuese dhe të sjelljes për lejedrejtimi mjeti është si më poshtë:

a) për lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, - 12 seanca në jo më pak se 12 ditë kalendarike;

b) për lejedrejtimi të kategorisë B1 - 12 seanca në jo më pak se 12 ditë kalendarike;

c) për lejedrejtimi të kategorisë B - 25 seanca në jo më pak se 25 ditë kalendarike. Për kategorinë B, përveç programit, kërkohet edhe ushtrim i detyrueshëm prej 6 orë siç përcaktohet në lidhjen 4;

d) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë AM në lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, - 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

e) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë AM në lejedrejtimi të kategorisë B1 - 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

f) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë AM në lejedrejtimi të kategorisë B - 20 seanca në jo më pak se 20 ditë kalendarike;

g) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë A1 në lejedrejtimi të kategorisë A2, B1 - 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

h) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë A1 në lejedrejtimi të kategorisë B - 15 seanca në jo më pak se 15 ditë kalendarike;

i) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë A2 në lejedrejtimi të kategorisë A, B1 - 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

j) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë A2, A në lejedrejtimi të kategorisë B - 15 seanca në jo më pak se 15 ditë kalendarike;

k) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë A në lejedrejtimi të kategorisë B1 - 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

l) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B1 në lejedrejtimi të kategorisë A1, A2- 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

m) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B1 në lejedrejtimi të kategorisë B - 15 seanca në jo më pak se 15 ditë kalendarike;

n) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B në lejedrejtimi të kategorisë B me kodin 96 - 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

o) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B në lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, - 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

p) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B në lejedrejtimi të kategorisë C1 - 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

q) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B në lejedrejtimi të kategorisë C - 15 seanca në jo më pak se 15 ditë kalendarike;

r) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B në lejedrejtimi të kategorisë BE - 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike;

s) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë C1 në lejedrejtimi të kategorisë C, C1E - 7 seanca në jo më pak se 7 ditë kalendarike;

t) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë C në lejedrejtimi të kategorisë CE – 7 seanca në jo më pak se 7 ditë kalendarike;

u) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë C në lejedrejtimi të kategorisë D1 - 7 seanca në jo më pak se 7 ditë kalendarike;

v) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë C në lejedrejtimi të kategorisë D - 8 seanca në jo më pak se 8 ditë kalendarike;

w) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë D1 në lejedrejtimi të kategorisë D, D1E - 7 seanca në jo më pak se 7 ditë kalendarike;



x) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë D në lejedrejtimi të kategorisë DE - 7 seanca në jo më pak se 7 ditë kalendarike.

Seanca e ushtrimit të praktikës të jetë jo më pak se 40 minuta.

Programi i përgatitjes praktike, kohëzgjatja e nevojshme dhe provimet për marrjen e lejedrejtimit të mjeteve me kuti shpejtësie automatike (kodi 78) është i njëjtë me ato të lejedrejtimit të mjeteve me kuti shpejtësie manuale për kategoritë përkatëse.

Kalimi nga një lejedrejtimi me kodin 78 në lejedrejtimi me kuti shpejtësie manuale brenda së njëjtës kategori bëhet me anë të kursit të përgatitjes praktike për 11 seanca në jo më pak se 11 ditë kalendarike.

Neni 20

Paraqitja e kandidatëve për prova

Sektori përkatës i DRSHTRR-së publikon grafikun e marrjes në prova, sipas autoshkollave dhe me orare të përcaktuara. Grafiku hartohet mbi bazën e kërkesave të bëra nga drejtuesit teknikë të autoshkollave dhe të kapaciteteve të DRSHTRR-së.

Procedurat e hartimit dhe publikimit të grafikut përcaktohen nga DPSHTRR-ja.

Kandidatët duhet të paraqiten në prova me dokumentin e identifikimit, si dhe lejen apo autorizimin përkatës.

Nënshtetasit e huaj duhet të paraqesin pasaportën, lejeqëndrimin ose kartë legjitimiteti për trupin diplomatik, si dhe lejen apo autorizimin përkatës.

Neni 21

Provimi i teorisë

1. Provimi i teorisë bëhet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ku ka adresën autoshkolla, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

Klasat janë të pajisura me materiale didaktike, siç përcaktohet në pikën 1/a, të nenit 5, të këtij udhëzimi, si dhe kamera për monitorimin e seancave.

Në pjesën balllore të klasës, vendosen tavolinat dhe njësia qendrore (kompjuterët) e anëtarëve të komisionit, të cilat në pjesën e përparme të tyre kanë një material transparent që lejon komunikimin në rast nevojë me klasën.

2. Kandidati ka në dispozicion 6 muaj për fitimin e provimit të teorisë, duke filluar nga data e lëshimit të lejes.

3. Prova e parë e teorisë nuk mund të jetë më parë se data e përfundimit të programit përgatitor të teorisë. Llogaritja e kësaj date bëhet duke filluar nga data e lëshimit të lejes dhe duke shtuar ditët kalendarike të përcaktuara.

4. Kandidati ka të drejtë të japë deri në 5 herë provimin e teorisë, jo më afër se 5 ditë kalendarike nga njëri provim në tjetrin. Në rast se kandidati nuk fiton provimin e teorisë brenda 6 muajve apo pas 5 herë paraqitje në provimin e teorisë, atëherë ai ka të drejtën e regjistrimit në autoshkollë nga e para pas përfundimit të vlefshmërisë së lejes.

Para çdo riprovimi bëhet pagesa përkatëse e shërbimit për riprovim.

5. Kandidati në momentin e provimit të teorisë duhet të paraqitet me kartën e identitetit ose pasaportën dhe lejen model DD/T.

6. Provimi i teorisë është i informatizuar. Numri i pyetjeve, koha maksimale e zhvillimit të provës së teorisë dhe gabimet e lejuara janë si më poshtë:

a) për lejedrejtimi të kategorisë AM – 30 pyetje, 30 minuta, 3 gabime;

b) për lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, B1 dhe B - 40 pyetje, 40 minuta, 4 gabime;

c) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë AM në lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, B1 dhe B - 40 pyetje, 40 minuta, 4 gabime;

d) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë B në lejedrejtimi të kategorisë C1, C - 40 pyetje, 40 minuta, 4 gabime;

e) për kalimin nga lejedrejtimi e kategorisë C në lejedrejtimi të kategorisë D1, D - 10 pyetje, 10 minuta, 1 gabim.

DPSHTRR-ja harton pyetjet e provimit të teorisë, në bashkëpunim me grupet e interesit, dhe përcakton sasinë e tyre për çdo temë dhe çdo vit bën përditësimin e tyre. DPSHTRR-ja duhet të njoftojë autoshkollat 30 ditë përpara se të zbatojë testet e reja dhe pyetjet i publikon në faqen zyrtare të saj.

Pyetjet duhet të jenë pohime, ku, afërsisht, 50% të tyre të jenë pohime të vërteta dhe pjesa tjetër të jenë pohime të gabuara.



Neni 22

Provimi i aftësisë drejtuese e të sjelljes

1. Kandidati ka në dispozicion 6 muaj për fitimin e provimit të praktikës, duke filluar nga data e lëshimit të autorizimit (model DD/P).

2. Vendi i provës të praktikës për të vlerësuar manovrat e veçanta bëhet në një terren të përshtatshëm për kryerjen e këtyre manovrave. Vendi i provës për të vlerësuar sjelljen në trafik duhet të bëhet në rrugë jashtë zonave të banuara, në rrugë interurbane dhe autostrada (ose të ngjashme), si dhe në të gjitha llojet e rrugëve urbane (zona banimi, zona ku lejohet shpejtësia prej 30 dhe 40 km/orë, rrugë urbane kryesore), të cilat duhet të përfaqësojnë lloje të ndryshme të vështirësisë. Gjithashtu, është e përshtatshme që prova të zhvillohet në kushte të ndryshme të trafikut.

3. Prova e parë e praktikës nuk mund të jetë më parë se data e përfundimit të programit të praktikës. Llogaritja e kësaj date bëhet duke filluar nga data e lëshimit të autorizimit për praktikë dhe duke shtuar ditët kalendarike të përcaktuara.

4. Kandidati lejohet të japë deri në 5 herë provimin e provës praktike, jo më afër se 5 ditë kalendarike nga njëra provë në tjetrën. Në rast se kandidati nuk e fiton provimin e praktikës me paraqitjen e tij deri në 5 herë prova praktike ose kalohet afati i vlefshmërisë së autorizimit të praktikës atëherë kandidati duhet të rifutet në provimin e teorisë, pa e përsëritur kursin e teorisë, vetëm pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së autorizimit përkatës.

Para çdo riprovimi bëhet pagesa e shërbimit për riprovim.

5. Kandidati në momentin e provimit të praktikës duhet të paraqitet me kartën e identitetit ose pasaportë dhe autorizimin model DD/P.

Për kategorinë B, kandidati duhet të ketë kryer edhe ushtrimin e praktikës prej 6 orësh, siç përcaktohet në lidhjen 4 të këtij udhëzimi, të firmosur nga instruktori i praktikës.

6. Kohëzgjatja e provimit të aftësive drejtuese e të sjelljes është:

- a) për lejedrejtimi të kategorisë A1, A2, A, B1, B, BE, B me kodin 96–25 minuta;
- b) për lejedrejtimi të kategorisë C1, C1E, C, CE, D1, D1E, D, DE - 45 minuta.

Kohët e përmendura në pikat “a” dhe “b” nuk

përfshijnë kohën përgatitore për kandidatin, automjetin, kontrollin teknik të automjetit me ndikim për sigurinë rrugore, manovrat e veçanta dhe shpalljen e rezultatit të testit praktik.

7. Për lejedrejtimi të kategorive A1, A2, A do të kryhen prova praktike sipas autorizimit DD/P (A1, A2, A) dhe lidhjes 4/1.

8. Për lejedrejtimi të kategorive B1 dhe B do të kryhen prova praktike sipas autorizimit DD/P (B1, B) dhe lidhjes 4/2.

9. Provimi i praktikës për lejedrejtimit e kategorisë BE, B me kodin 96, C1E, CE, D1E, DE bëhet në dy faza. Në fazën e parë rimorkio është e ndarë nga mjeti. Kandidati pyetet për lidhjen e rimorkios dhe provohet për lidhjen praktike të saj. Në fazën e dytë zhvillohet prova e aftësisë drejtuese e të sjelljes.

10. Instruktori i praktikës duhet të jetë prezent në mjet dhe gjatë ushtrimit të provave të praktikës, përveç mjeteve të kategorisë A1, A2 dhe A.

Neni 23

Vlerësimi nga komisioni i provimit të aftësive drejtuese e të sjelljes

Vlerësimi i aftësive drejtuese e të sjelljes bëhet pasi të jetë bërë përgatitja e tyre sipas programit. Kontrolli i njohurive duhet të reflektojë shkallën e lehtësisë me të cilën kandidati menaxhon kontrollin e mjetit dhe aftësitë e tij për të drejtuar mjetin në trafik me siguri të plotë. Anëtarët e komisionit duhet të ndjehen të sigurt gjatë testit. Gabimet e drejtimit të mjetit ose drejtimi që rrezikon sigurinë rrugore, pasagjerët e tij apo përdorues të tjerë të rrugës do të penalizohen me dështimin e testit, pavarësisht nëse anëtarët e komisionit apo instruktoret të praktikës i duhet të ndërhyjnë ose jo. Megjithatë, anëtari i komisionit do të jetë i lirë të vendosë nëse testi i aftësive dhe sjelljes duhet të përfundojë apo jo.

Gjatë vlerësimit të tyre, anëtarët e komisionit duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë nëse kandidati tregon sjellje justifikuese (korrekte) dhe sociale gjatë drejtimit të mjetit, gjë që merret parasysh në vlerësimin përfundimtar. Kjo përfshin drejtimin e përshtatur dhe të sigurt të mjetit, duke marrë parasysh kushtet e rrugës dhe motit, duke marrë parasysh lëvizjet e tjera, duke marrë parasysh interesat e përdoruesve të tjerë të rrugës (veçanërisht ata më të dobët) dhe parashikimet e situatave.



Anëtarët e komisionit duhet të tregojnë itinerarin e lëvizjes. Komisioni nuk duhet të urdhërojë lëvizjen e mjetit në kundërshtim me rregullat e Kodit Rrugor.

Komisioni i marrjes në prova të praktikës mban shënime, vëzhgon dhe vlerëson se si kandidati:

- kontrollon mjetin, vendos rripin e sigurimit, rregullon pasqyrat dhe mbështetësen e kokës, rregullon sediljen, përdor dritat dhe pajisjet e tjera, përdor friksionin, kutinë e shpejtësisë, pedalin e gazit, sistemin e frenimit, sistemin e drejtimit etj.;

- drejton mjetin në shpejtësi të ndryshme, vendos ngarkesën dhe siguron komoditetin e pasagjerëve (jo rritje të menjëhershme të shpejtësisë, drejtim i qetë i mjetit dhe jo frenim i fortë) etj.;

- drejton mjetin në mënyrë ekonomike dhe kujdeset për mjedisin duke marrë parasysh xhirot e motorit, ndërrimet e shpejtësisë, frenimet dhe përsheptimin (vetëm për kategoritë BE, C, CE, C1, C1E, D, DE, D1, D1E);

- përdor në mënyrë të duhur pasqyrat për shikimin në distancë të largët, të mesme dhe të afërt;

- zbaton përparësinë: përparësia në kryqëzime, në hyrje rrugësh, në rast lëvizje prapa, në rast kthimi të sensit të lëvizjes etj.;

- pozicionon mjetin në rrugë: pozicioni i duhur në rrugë, në korsi, në rrethrotullime, në kthesa, të përshtatshme për llojin dhe karakteristikat e automjetit, para kryqëzimeve;

- mban distancën: mbajtja e distancës së duhur në pjesën e përparme dhe anash, mbajtja e distancës së duhur nga përdoruesit e tjerë të rrugës;

- zbaton shpejtësinë e lëvizjes: mostejkalimi i shpejtësisë maksimale të lejuar, përshtatja e shpejtësisë me kushtet e motit, trafikut etj. Mbajtja e një shpejtësie të tillë që të jetë në gjendje të ndalojë kur është e nevojshme;

- kontrollon dhe zbaton sinjalet e policit, semaforët, sinjalet vertikale dhe horizontale;

- zbaton rregullat në përdorimin e sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit të mjetit;

- frenon dhe ndalon sipas kushteve të rrugës dhe trafikut. Përdorimi i bllokazhit të motorit (vetëm për kategoritë C, CE, D, DE);

- parashikon më përpara situatat.

Pas shpalljes fitues të kandidatit në provimin e praktikës, ai duhet të bëjë pagesën për tarifën e pajisjes me lejedrejtimi (taksa e buxhetit) dhe

pagesën për pajisje me lejedrejtimi mjete (shërbimi dhe vlera e kartës së lejedrejtimimit).

Neni 24

Kontrolli i autoshkollave

Autoshkollat janë objekt kontrolli, në mbështetje të nenit 121 të Kodit Rrugor, të ndryshuar, të nenit 314 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 dhe sipas këtij udhëzimi.

PJESA II

KUALIFIKIMI I INSTRUKTORËVE TË AUTOSHKOLLAVE

Neni 25

Kërkesat ndaj instruktorëve të autoshkollës

Mësuesit e teorisë dhe instruktorët e praktikës, për të ushtruar detyrën, përveç kushteve të nenit 313, pika 12, e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor, duhet të jenë të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale, të lëshuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 26

Procedura e marrjes së Dëshmisë së Aftësisë Profesionale

Aplikanti që kërkon të pajiset me Dëshmi të Aftësisë Profesionale duhet të pajiset me autorizim nga DRSHTTRR-ja, vlefshmëria e të cilit është 6 muaj nga data e lëshimit të tij.

Për të fituar Dëshminë e Aftësisë Profesionale, për mësues teorie apo për instruktor praktike në autoshkollë, aplikanti duhet të përvetësojë programin sipas lidhjes 5 të këtij udhëzimi dhe të fitojë provat. Aplikanti i regjistruar për instruktor praktike duhet të fitojë edhe provat e praktikës për kategorinë e lejedrejtimimit që kërkon.

Organizimi i testimit të mësuesve të teorisë dhe instruktorëve të praktikës kryhet nga DPSHTRR-ja. Testet e provimit për marrjen e dëshmisë si mësues teorie apo instruktor praktike, duhet të përmbajnë programet e njohurive teorike dhe të praktikës sipas lidhjes 5 të këtij udhëzimi.

Aplikanti ka të drejtë të paraqitet në prova pasi të marrë autorizimin e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Komisioni i marrjes në prova përbëhet nga tre specialistë, inxhinierë mekanikë, të DPSHTRR-së.

Vlerësimi i aplikantit për mësues teorie në autoshkollë do të konsiderohet pozitiv, nëse gjatë



plotësimin të testit përkatës janë dhënë përgjigje të gabuara jo më shumë se 6 (gjashtë) nga 60 pyetje që përmban testi.

Vlerësimi teorik i aplikantit për instruktor praktikë në autoshkollë do të konsiderohet pozitiv, nëse gjatë plotësimin të testit përkatës janë dhënë përgjigje të gabuara jo më shumë se 3 (tri) nga 30 pyetje që përmban testi.

Aplikanti ka të drejtë të futet në provim deri në 5 (pesë) herë, brenda vlefshmërisë së autorizimit përkatës. Nga njëri provim me rezultat negativ në tjetrin duhet të kalojnë jo më pak se 15 ditë.

Në rast se aplikanti nuk shpallet fitues për 5 (pesë) prova ose në rast se kalohet afati i vlefshmërisë së autorizimit atëherë aplikanti ka të drejtë reregjistrimi vetëm pas përfundimit të vlefshmërisë së autorizimit.

Dokumentacioni i provimit dhe rezultatet, evidentohen në regjistrat përkatës të DPSHTRR-së dhe arkivohen.

Dëshmitë e lëshuara nga DPSHTRR-ja plotësohen për mësuesit e teorisë dhe për instruktorët e praktikës për kategorinë e lejedrejtimit që ai zotëron.

Mësuesit e teorisë mund të marrin të dyja llojet e dëshmimeve, me kusht që të fitojnë edhe provat e praktikës për kategorinë e lejedrejtimit që kërkojnë, si dhe të plotësojnë kriteret që kërkohen për instruktorët e praktikës.

PJESA III KËRKESAT PËR KONTROLLORËT (SPECIALISTËT) E DPSHTRR-së

Neni 27

Detyrat që ushtrojnë kontrollorët e DPSHTRR-së

Kontrollorët (specialistët) e DPSHTRR-së duhet të jenë të përgatitur që të ushtrojnë detyrat, për:

- marrje në prova të kandidatëve për t'u pajisur me lejedrejtimi;
- marrje në prova të mësuesve dhe instruktorëve të autoshkollave për t'u pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale;
- verifikim dhe kontroll të veprimtarisë së autoshkollave.

Neni 28

Kërkesat ndaj anëtarëve të komisionit (kontrollorëve) të provave të teorisë dhe praktikës

Kontrollori, për të kryer vlerësimin e provës mbi performancën e drejtimit të mjetit të një kandidati, duhet të ketë njohuri dhe aftësi si më poshtë:

1. Të jetë kompetent në vlerësimin e performancës së kandidatit që kërkon të pajiset me lejedrejtimi.

2. Të ketë njohuri në drejtimin e mjetit, si dhe të zotërojë:

- teorinë e mënyrës së drejtimit të mjetit. Për këtë qëllim mund të përdoren edhe metodika për mësimdhënien në teori dhe praktikë për përgatitjen e kandidatëve në drejtimin e mjetit të bazuara mbi botime apo publikime bashkëkohore;

- të kuptuarit e rrezikut dhe shmangien e aksidentit;

- programin mësimor që përcakton standardet e provës së drejtimit të mjetit;

- kërkesat e provës në drejtimin e mjetit;
- legjislacionin përkatës rrugor dhe të trafikut, që përfshin legjislacionin kombëtar dhe atë të Bashkimit Evropian;

- teorinë e vlerësimit dhe teknikat;

- drejtimin e sigurt të mjetit (që nënkupton mbajtjen gjithmonë të rripit të sigurimit gjatë drejtimit të mjetit, shmangien e shpejtësive të larta, të mos jesh një drejtues agresiv etj.);

3. Të ketë aftësi për të vlerësuar.

Aftësia për të vëzhguar me saktësi, për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e përgjithshme të kandidatit, në veçanti:

- njohjen korrekte dhe të hollësishme të situatave të rrezikshme;

- përcaktimin e saktë të shkakut dhe efektin e pritshëm të situatave të tilla;

- arritjen e kompetencës dhe njohjen e gabimeve;

- njëtrajzshmërinë dhe linjën logjike në vlerësim;

- përvetësim të shpejtë të informacionit dhe nxjerrjen e pikave kyçe;

- vështrimi përpara, identifikimi i problemeve të mundshme dhe reagimet për t'i zgjidhur ato;

- të sigurojë reagim në kohë dhe konstruktiv.

4. Të ketë aftësi personale në drejtimin e mjetit.

Kontrollorët që vlerësojnë provën e praktikës



për një kategori lejdrejtimi duhet të zotërojnë lejdrejtimi për këtë kategori dhe të jenë në gjendje të drejtojnë atë tip mjeti me një standard të lartë.

5. Të ketë komunikim dhe shërbim cilësor.

Kontrollori duhet:

- t'i tregojë dhe komunikojë kandidatit veprimet që ai do të kryejë gjatë provës;

- të komunikojë qartë, duke zgjedhur përmbajtjen, stilin dhe gjuhën në mënyrë që t'i përshtatet audiencës, kontekstit, si dhe të kujdeset për kërkesat e kandidatëve;

- të jetë i qartë në dhënien e rezultateve të provimit të provës praktike;

- të trajtojë kandidatët me respekt dhe pa diskriminim.

6. Të ketë njohuri mbi teknikën dhe fizikën e mjetit.

Kontrollori duhet të ketë:

- njohuri mbi teknikën e mjetit, siç janë: sistemi i drejtimit, gomat, sistemi i frenimit, sistemi i ndriçimit, në mënyrë të veçantë për motorët dhe mjetet e rënda;

- njohuri për ngarkimin e sigurt të mjetit;

- njohuri mbi fizikën e mjetit si shpejtësia, fërkimi, dinamika, energjia.

7. Të ketë njohuri mbi drejtimin e mjetit në një mënyrë miqësore me mjedisin dhe me efikasitet në konsumin e karburantit.

8. Në DRSHTRR ku ka më shumë se një komision të marrjes në prova, anëtarët e komisioneve duhet të qarkullojnë midis provave të teorisë dhe praktikës. Mënyra dhe koha e qarkullimit caktohet nga DPSHTRR-ja.

Neni 29

Kriteret, kualifikimi fillestar dhe trajnimet periodike për kontrollorët e provës së teorisë dhe praktikës

1. Kontrollorët që marrin në provë praktike kandidatët për drejtues mjeti për kategoritë A, B dhe nënkategoritë e tyre (A1, A2, B1, BE, B me kodin 96) duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë mbajtës të lejdrejtimit të kategorisë A dhe B (me nënkategoritë e tyre) prej të paktën 7 (shtatë) vite;

- të jenë të paktën 30 vjeç;

- të kenë përfunduar me sukses kualifikimin fillestar (trajnimin fillestar dhe provimin) të cituar në pikën 3 të këtij neni dhe më pas të kenë

plotësuar kërkesat e sigurimit të cilësisë, të kenë bërë trajnime periodike, siç cilësohet në pikën 4 të këtij neni;

- të kenë përfunduar një arsim profesional, inxhinier mekanik;

- të mos jenë aktivë njëherësh dhe si instruktorë drejtimi në një autoshtet.

2. Kontrollorët që marrin në provë praktike kandidatët për drejtues mjeti për kategoritë C1, C1E, C, CE, D1, D1E, D, DE duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të jenë mbajtës të lejdrejtimit të kategorisë përkatëse;

- të kenë përfunduar me sukses kualifikimin fillestar (trajnimin fillestar dhe provimin) të cituar në pikën 3 të këtij neni dhe më pas të kenë plotësuar kërkesat e sigurimit të cilësisë, të kenë bërë trajnime periodike, siç cilësohet në pikën 4 të këtij neni;

- duhet të kenë qenë kontrollorë të kualifikuar në kategorinë B për të paktën 3 (tre) vjet. Kjo periudhë mund të mos merret parasysh nëse ata kanë të paktën 5 (pesë) vite drejtim mjeti në kategorinë përkatëse dhe janë mbi 30 vjeç;

- të kenë përfunduar një arsim profesional, inxhinier mekanik;

- të mos jenë aktiv njëherësh dhe si instruktor drejtimi në një autoshtet.

3. Kualifikimi fillestar

3.1 Trajnimi fillestar

Përpara se kontrollorët të autorizohen të vlerësojnë provat praktike të kandidatëve për drejtues mjeti, ata duhet të përfundojnë kënaqshëm një program të tillë trajnimi, në mënyrë që të kenë kompetencat e përcaktuara në nenin 28 të këtij udhëzimi.

Programi i trajnimit të kualifikimit fillestar shërben për të vlerësuar provat praktike të drejtimit të mjetit për një ose më shumë kategori lejdrejtimi.

Programi i trajnimit përgatitet nga DPSHTRR-ja.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në përfundim të trajnimit të kualifikimit fillestar, lëshon certifikatë për kryerjen e këtij trajnimi.

Modeli i certifikatës për kryerjen e trajnimit të kualifikimit fillestar hartohet dhe miratohet nga DPSHTRR-ja.

3.2 Provimi

Përpara se kontrollorët të autorizohen të



vlerësojnë provat praktike të kandidatëve për drejtues mjeti, ata duhet të tregojnë një standard të kënaqshëm njohurish dhe kompetencë për sa u përket temave të renditura në nenin 28 të këtij udhëzimi.

Procesi i marrjes në provim vlerëson, në një mënyrë të përshtatshme pedagogjike, kompetencat e kontrollorëve, siç përcaktohet në nenin 28, në veçanti pika 3. Procesi i marrjes në provim përfshin, gjithashtu, elemente teorike dhe elemente praktike. Vlerësimi me bazë kompjuterin mund të përdoret, kur vlerësohet e përshtatshme. Detajet në lidhje me natyrën dhe kohëzgjatjen e çdo testi dhe vlerësimet e provimit propozohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe miratohen nga ministri përgjegjës për transportin.

Provimi bëhet për kontrollorët që do të autorizohen për të vlerësuar prova në një kategori të caktuar lejedrejtimi ose për kontrollorët që do të autorizohen për të vlerësuar prova për kategori të caktuara lejedrejtimi.

Komisioni i marrjes në provim do të përcaktohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të DPSHTRR-së dhe do të ketë në përbërje përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Ministri përgjegjës për transportin mund të caktojë përfaqësues, të cilët nuk janë punonjës të DPSHTRR-së, inxhinierë mekanikë, pa ndryshuar kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje.

Në përfundim të procesit të marrjes në provim, për kontrollorët me rezultate pozitive, komisioni i marrjes në provim lëshon dëshminë për marrjen e provimit të kualifikimit fillestar.

Modeli i dëshmisë për marrjen e provimit të kualifikimit fillestar miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me plotësimin e kërkesave sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, specialisti fiton të drejtën e kontrollorit të provave të praktikës.

4. Sigurimi i cilësisë dhe trajnimi periodik

4.1 Sigurimi i cilësisë

DPSHTRR-ja, në vazhdimësi duhet të marrë masa për të siguruar cilësi dhe standarde për kontrollorët e saj.

Masat e sigurimit të cilësisë përfshijnë mbikëqyrjen e kontrollorëve në punë, trajnimin e tyre të mëtejshëm, zhvillimin e tyre profesional në vazhdimësi dhe rishikimin periodik në vlerësimin e

provave praktike që ata kanë kryer. Mbi këtë bazë, DPSHTRR-ja duhet të bëjë vlerësim vjetor për kontrollorët.

DPSHTRR-ja duhet të sigurojë që çdo kontrollor mbikëqyret në kryerjen e provave praktike një herë në 5 (pesë) vjet, për një periudhë të përgjithshme minimale prej të paktën një gjysmë dite, që lejon mbikëqyrjen e disa provave. Kur identifikohen probleme ndërmerren veprime përkatëse nga strukturat e caktuara të DPSHTRR-së për zgjidhjen e tyre. Personat që ndërmarrin mbikëqyrjen duhet të jenë të autorizuar për këtë qëllim nga DPSHTRR-ja.

Kontrollorët mund të autorizohen për të vlerësuar prova drejtimi në më shumë se një kategori, kur plotësojnë kërkesat përkatëse.

Procesi i marrjes në provim të kontrollorëve që autorizohen për të vlerësuar prova të drejtimit të mjetit duhet të monitorohet dhe mbikëqyret nga ministria përgjegjëse për transportin, për të siguruar zbatimin me korrektësi dhe në mënyrë të qëndrueshme të vlerësimit.

4.2 Trajnimi periodik

DPSHTRR-ja duhet të sigurojë që kontrollorët e drejtimit të mjeteve, pavarësisht numrit të kategorive që u njihen, të marrin një trajnim periodik të rregullt minimumi prej 4 (katër) ditësh në total për një periudhë 2-vjeçare (dyvjeçare), në mënyrë që:

- të ruajnë dhe të rifreskojnë njohuritë e nevojshme dhe aftësitë e nevojshme për marrjen në provim të kandidatëve;

- të zhvillojnë kompetenca të reja që janë të domosdoshme për ushtrimin e profesionit të tyre;

- të sigurojnë që provimi i provës së praktikës kryhet me një standard të paanshëm dhe të drejtë;

- të kryejnë një trajnim periodik minimalisht me një kohëzgjatje për të paktën 5 (pesë) ditë në total për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare);

- të zhvillojnë dhe ruajnë aftësitë praktike të nevojshme të drejtimit të mjetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor duhet të marrë masa të përshtatshme që t'i jepet trajnimi i veçantë i menjëhershëm kontrollorëve që kanë performuar dobët, bazuar në rregullat e sigurimit të cilësisë.

Natyra e trajnimit periodik mund të ketë formën e udhëzimeve, trajnim në klasë, mësim tradicional apo me bazë elektronike, dhe mund të kryhet mbi baza individuale apo grupi. Ai mund të përfshijë



standarde që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor i konsideron të përshtatshme.

Kontrollorët e autorizuar që kryejnë prova të drejtimit të mjetit në më shumë se një kategori, duhet të plotësojnë kërkesat e trajnimit periodik në përputhje me provat për më shumë se një kategori, duke siguruar përmbushjen e kushtit që nëse, kontrollorët nuk kanë zhvilluar prova për një kategori brenda një periudhe 2-vjeçare (dyvjeçare), kontrollorët duhet të ndërmarin një rivlerësim të përshtatshëm përpara se të lejohen të kryejnë prova drejtimi mjeti në përputhje me atë kategori. Ky rivlerësim mund të ndërmerret si pjesë e kërkesave të përcaktuara në pikat e mësipërme.

5. Të drejtat e fituara

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor mund të lejojë kontrollorët aktualë që të vazhdojnë të kryejnë prova drejtimi mjeti, pavarësisht se ata nuk janë të autorizuar në përputhje me kriteret e këtij udhëzimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor duhet të sigurohet që kontrollorët aktualë të vlerësimin të teorisë dhe praktikës brenda datës 1 janar 2017, të plotësojnë kërkesat e parashikuara në të, me përjashtim të kohës së zotërimit të lejedrejtimit të kategorive A dhe B (me nënkategoritë e tyre) prej të paktën 7 (shtatë) vjet.

PJESA IV TË FUNDIT

Neni 30

Marrja dhe rinovimi i lejedrejtimit

Marrja e lejedrejtimit bëhet në çdo drejtori rajonale sipas kërkesës së kandidatëve. Lejedrejtimi rinovohet sipas afateve të vlefshmërisë sikurse është e përcaktuar në nenin 124 të Kodit Rrugor.

Neni 31

Ruajtja e dokumentacionit

Autoshkollat, drejtoritë rajonale dhe DPSHTRR-ja ruajnë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në këtë udhëzim, sipas kërkesave të ligjit për arkivat.

Neni 32

Shfuqizime

Udhëzimi nr. 994, datë 12.3.2003, i ndryshuar, “Për organizimin dhe funksionimin e auto-shkollave”, shfuqizohet në datën e bërjes efektive të këtij udhëzimi.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare. Efektet e tij fillojnë më datë 1 janar 2017.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

Lidhja 1

KATEGORITË E LEJEDREJTIMIT DHE MOSHAT MINIMALE TË KANDIDATËVE

Lejedrejtimi	Aftësia për të drejtuar
Kategoria AM Moshë minimale 16 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> ciklomotorë me dy rrota, kategoria L1, projektuar me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/orë dhe jo më shumë se 45 km/orë, cilindritë e të cilit është më e vogël ose e barabartë me 50 cm³, nëse është me djegie të brendshme, ose fuqia nominale e vazhduar e të cilit është më e vogël apo e barabartë me 4 kw, për motorët elektrikë; mjete me tri rrota, kategoria L2, projektuar me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/orë dhe jo më shumë se 45 km/orë dhe me motor me cilindratë më të ulët ose të barabartë me 50 cm³, nëse është me ndezje të komanduar, ose fuqia maksimale e të cilit është më e ulët apo e barabartë me 4 kw, për motorët e tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia nominale e vazhduar e të cilit është më e vogël ose e barabartë me 4 kw, për motorët elektrikë; mjete me katër rrota të lehta, kategoria L6, masa bosh e të cilave është më e ulët ose e barabartë me 350 kg, duke përjashtuar masën e baterive për mjetet elektrike, projektuar me shpejtësi maksimale më të madhe se 25 km/orë dhe jo më shumë se 45 km/orë, me cilindratë të motorit më të ulët ose të barabartë me 50 cm³, për motorët me ndezje të



	komanduar, ose fuqia maksimale e të cilit është më e ulët apo e barabartë me 4 kw, për motorët e tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia nominale e vazhduar e të cilit është më e vogël ose e barabartë me 4 kw, për motorët elektrikë.
Kategoria A1 Moshë minimale 18 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> motor pa kosh (kategoria L3) me cilindrata deri 125 cm³ dhe fuqi max deri 11 kw, me raport fuqi/peshë jo më shumë se 0.1 kw/kg; motor me kosh (kategoria L4) me cilindrata deri 125 cm³ dhe fuqi max deri 11 kw, me raport fuqi/peshë jo më shumë se 0.1 kw/kg; trickël (motomjete me tri rrota, simetrike ndaj aksit gjatësor, kategoria L5), me fuqi deri 15 kw; makina bujqësore dhe komplekset e mjeteve bujqësore që nuk i kalojnë kufijtë e përcaktuar në nenin 53, pika 4 e Kodit Rrugor (gjerësia: 1.6 m, gjatësia: 4m, lartësia 2.5 m, masa maksimale e autorizuar me ngarkesë: 2.5 tonë, shpejtësia: 40 km/orë).
Kategoria A2 Moshë minimale 18 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> motor pa kosh (kategoria L3), me fuqi maksimale deri 35 kw, me raport fuqi/peshë jo më shumë se 0.2 kw/kg dhe që nuk rrjedh nga një mjet me më shumë se dyfishi i fuqisë së tij; motor me kosh (kategoria L4) me fuqi maksimale deri 35 kw, me raport fuqi/peshë jo më shumë se 0.2 kw/kg dhe që nuk rrjedh nga një mjet me më shumë se dyfishi i fuqisë së tij.
Kategoria A Të paktën 2 vjet pas A2	<ul style="list-style-type: none"> motomjete me fuqi më të madhe se 15 kw (motomjete me tri rrota, simetrike ndaj aksit gjatësor) dhe me kusht që të jenë mbi 21 vjeç; motorët pa kosh (L3) ose me kosh (L4) që nuk i përkasin kategorive A1 dhe A2.
Kategoria B1 Moshë minimale 18 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> motomjete me katër rrota, të ndryshëm nga ato të kategorive A1, masa pa ngarkesë e të cilave është më e vogël ose e barabartë me 400 kg ose 550 kg për mjetet e destinuara për transport mallrash (kategoria L7), përjashtuar masën e baterive për mjetet elektrike, të cilat fuqinë maksimale neto të motorit e kanë më të ulët ose të barabartë me 15 kw; mjete të tjera që konsiderohen motomjete me tri rrota simetrike ndaj aksit gjatësor (të kategorisë L5).
Kategoria B Moshë minimale 18 vjeç	<ul style="list-style-type: none"> automjete me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3500 kg dhe me jo më shumë se 8 ndenjësë, përjashtuar ndenjësën e drejtuesit të mjetit. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio të lehtë ose një gjysmërimorkio që nuk e kalon masën maksimale të autorizuar 750 kg; motomjete me tri rrota simetrike ndaj aksit gjatësor me fuqi më të madhe se 15 kw; motomjete të kategorisë A1 me kusht që mbajtësi i lejdrejtimit të jetë të paktën 21 vjeç; makinat bujqësore; makinat teknologjike.
Kategoria B me kodin 96 Të paktën 1 vit pas B	<ul style="list-style-type: none"> kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkio ose gjysmërimorkioje që i kalon 750 kg, kur masa maksimale e autorizuar e një kombinimi të tillë është sidoqoftë më e vogël se 4250 kg.
Kategoria BE Të paktën 1 vit pas B	<ul style="list-style-type: none"> kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkio ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios nuk i kalon 3500 kg;
Kategoria C1 Të paktën 1 vit pas B	<ul style="list-style-type: none"> automjete të ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të cilëve i kalon 3500 kg, por jo më shumë se 7500 kg ose i projektuar dhe i konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg; autokampe
Kategoria C1E Të paktën 1 vit pas C1	<ul style="list-style-type: none"> kombinimi i një mjeti motorik të kategorisë C1 dhe një rimorkioje ose gjysmërimorkioje, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg, por masa maksimale e autorizuar e kompleksit të formuar nuk i kalon 12000 kg; kombinimi i një mjeti të kategorisë B dhe një rimorkioje apo gjysmërimorkioje, masa e autorizuar e të cilave i kalon 3500 kg, me kusht që, në masë, kombinimi i autorizuar të mos i kalojë 12000 kg.
Kategoria C	<ul style="list-style-type: none"> automjete të ndryshëm nga ato të kategorive D1 e D, masa maksimale e autorizuar e të



Të paktën 3 vjet pas B	cilëve i kalon 3500 kg dhe të projektuar e konstruktuar për transportin e jo më shumë se tetë pasagjerëve, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk e kalon 750 kg.
Kategoria CE Të paktën 1 vit pas C	• kombinimi i një mjeti të kategorisë C me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg.
Kategoria D1 Të paktën 1 vit pas C	• automjet i projektuar dhe konstruktuar për jo më shumë se 16 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit, dhe me gjatësi maksimale që nuk i kalon 8 m. Mjetet e kësaj kategorie mund të tërheqin një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg.
Kategoria D1E Të paktën 1 vit pas D1	• kombinim i një mjeti të kategorisë D1 me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg.
Kategoria D Të paktën 3 vjet pas C	• automjete të projektuar dhe konstruktuar për transportin e më shumë se 8 pasagjerë, përjashtuar drejtuesin e automjetit. Mjeteve të kësaj kategorie mund t'u lidhet një rimorkio, masa maksimale e autorizuar e së cilës nuk i kalon 750 kg;
Kategoria DE Të paktën 1 vit pas D	• kombinimi i një mjeti të kategorisë D me një rimorkio ose gjysmërimorkio, ku masa maksimale e autorizuar e rimorkios ose gjysmërimorkios është më shumë se 750 kg.

Lidhja 2

KALIMI NGA NJË LEJEDREJTIMI EKZISTUESE NË NJË LEJEDREJTIMI TË NJË
KATEGORIE TJETËR

LEJEDREJTIMI QË ZOTËROHET		LEJEDREJTIMI QË KËRKOHET	PROVIMI
Kategoria AM	→	Kategoria A1, A2, B1 ose B	Provë teorie + provë praktike
Kategoria A1	→	Kategoria A2	Provë praktike
Kategoria A2	→	Kategoria A	Provë praktike
Kategoria A1, A2, A, B1	→	Kategoria B	Provë praktike
Kategoria B	→	Kategoria A1, A2	Provë praktike
Kategoria B	→	Kategoria BE, B me kodin 96	Lidhje rimorkio + provë praktike
Kategoria B	→	Kategoria C1, C	Provë teorie + provë praktike
Kategoria C1	→	Kategoria C	Provë praktike
Kategoria D1	→	Kategoria D	Provë praktike
Kategoria C1, C, D1, D	→	Kategoria C1E, CE, D1E ose DE	Lidhje rimorkio + provë praktike
Kategoria C	→	Kategoria D1, D	Provë teorie + provë praktike
Kategoria CE + D	→	Kategoria DE	Pa prova



PROGRAMI DHE PROVIMI I TEORISË

Programi i përgatitjes teorike në autoshkolla duhet të mbështetet në parimet e Kodit Rrugor dhe akteve në zbatim të tij.

Programi i përgatitjes teorike është në funksion të kategorisë së lejedrejtimit dhe përfshin njohuritë mbi: rrugët; mjetet rrugore; kërkesat ndaj drejtuesve të mjeteve; kategoritë dhe vlefshmëria e lejeve të drejtimit; dokumentet e nevojshme për qarkullim; sinjalistika rrugore; normat e sjelljes; rregullat dhe legjislacioni për qarkullim me mjete që transportojnë mallra apo udhëtarë; ndotjen e mjedisit; shkaqet e aksidenteve rrugore.

Kontrulli i njohurive teorike bëhet nëpërmjet provimit të teorisë. Pyetjet e provimit të teorisë janë në përputhje me programin e përgatitjes teorike dhe hartohen në bazë të temave të përcaktuara për çdo kategori lejedrejtimi, si më poshtë:

Temat për kategorinë AM

1. Sinjalet e rrezikut, sinjalet e përparësisë;
2. Sinjalet e ndalimit, sinjalet e detyrimit, panelet plotësuese;
3. Sinjalet treguese, sinjalet e ndritshme, sinjalet e policëve të trafikut;
4. Rregullat e dhënies së përparësisë, sinjalet me drita, sinjalet horizontale;
5. Shpejtësia dhe kufijtë e saj, distanca e sigurisë, parakalimi, kthimi, ndryshimi i korsisë, ndryshimi i drejtimit;
6. Ndalimi, qëndrimi, pushimi dhe nisja; përkufizimet e rrugëve; përkufizimet e ciklomotorëve, drejtuesi i mjetit, lejedrejtimi i kategorisë AM;
7. Shkaqet e aksidenteve, sjellja në rast aksidenti, përgjegjësitë në një aksident rrugor; sigurimi i detyrueshëm;
8. Elementet e ciklomotorit dhe përdorimi i tyre, kaska mbrojtëse;
9. Sjelljet gjatë drejtimit të ciklomotorit; respektimi i mjedisit; kufizimi i ndotjes; shikueshmëria e drejtuesve të motomjeteve nga përdoruesit e tjerë të rrugës;
10. Edukimi ligjor. Ndikimi i alkoolit dhe i drogave në drejtimin e mjetit. Sanksionet ligjore për shkeljet e rregullave të qarkullimit.

Provimi i informatizuar

Testi ka 30 (tridhjetë) pyetje të pavarura, tri për çdo temë, që bien në mënyrë rastësore.

Koha – 30 (tridhjetë) minuta.

Gabimet e lejuara - 3 (tri).

Temat për kategoritë A1, A2, B, B1

Temat më të rëndësishme që kanë 2 pyetje për çdo test provimi

1. Sinjalet e rrezikut;
2. Sinjalet e ndalimit;
3. Sinjalet e detyrimit;
4. Sinjalet e përparësisë;
5. Sinjalet horizontale dhe sinjalet që tregojnë pengesa;
6. Sinjalet semaforike dhe të policëve të trafikut;
7. Kufijtë e shpejtësisë, rreziku në trafikun e ngarkuar, sjellja në kalimet në nivel;
8. Distanca e sigurisë, parimet më të rëndësishme në lidhje me respektimin e një distance të sigurt mes mjeteve, distancat e frenimit dhe zotërimi i rrugës në gjendje të ndryshme, si dhe të kushteve të motit, faktorët e rrezikut të drejtimit që kanë lidhje me kushtet e ndryshme të rrugëve, veçanërisht nëse ato ndryshojnë sipas motit dhe kohës, ditë apo natë;
9. Rregullat e qarkullimit të mjeteve; pozicioni i mjeteve në karrexhatë; ndryshimi i drejtimit të lëvizjes (kthimi); sjellja në prani të funeraleve, kortezheve dhe kolonave ushtarake; sjellja në kryqëzime; rregullat e përparësisë; detyrimet kundrejt mjeteve të policisë dhe të urgjencës; rreziqet e lidhura me manovrat, me drejtimin e tipave të ndryshëm të mjeteve dhe me fushëpamjen e kufizuar të drejtuesit të mjetit.



10. Shembuj të përparësisë (rregullat e përparësisë në kryqëzime);
11. Rregullat e parakalimit;
12. Rregulla të ndryshme, si: zënia e karrexhatës; sinjalizimi i mjetit të ndaluar; rregullat e qarkullimit në autostradë dhe rrugë interurbane kryesore; transporti i udhëtarëve; ngarkesa e mjeteve; panelet mbi mjete; tërheqja e mjeteve në avari; tërheqja e rimorkiove.
13. Sistemet e pajimit; funksioni dhe përdorimi; rripat e sigurimit dhe sistemet e fiksimit për fëmijët; kasko mbrojtëse dhe veshjet e sigurisë;
14. Sjelljet për parandalimin e aksidenteve rrugore; sjellja në rast të aksidenteve rrugore, kujdesi gjatë drejtimit të motorëve;
15. Kuptimi, gjykimi dhe vendimmarrja, në veçanti koha e reagimit, si dhe ndryshimet në sjelljen e drejtimit të mjetit nën ndikimin e alkoolit, drogës dhe medikamenteve mjekësore, gjendjes mendore dhe lodhjes;
Temat e tjera që kanë vetëm 1 pyetje për çdo test provimi
16. Përkufizimet rrugore dhe të trafikut; përkufizimet dhe klasifikimi i mjeteve; detyrat e drejtuesve të mjeteve në përdorimin e rrugës; bashkëpunimi civil dhe përdorimi i rrugës me përgjegjshmëri; Kujdesi kundrejt përdoruesve të dobët të rrugës (të moshuarve, invalidëve, fëmijëve, këmbësorëve, çiklistëve);
17. Sinjalet treguese;
18. Sinjalet plotësuese; sinjalet e përkohshme të kantierit;
19. Panelet plotësuese;
20. Ndalimi, qëndrimi, pushimi dhe nisja;
21. Përdorimi i dritave, pajisjeve akustike, llambave spinë dhe simboleve;
22. Lejedrejtimi; dokumentet e qarkullimit të mjetit, targat e mjeteve, detyrimi kundrejt funksionarëve dhe agjentëve të policisë; sanksionet; lejedrejtimi me pikë; përdorimi i lenteve dhe aparateve të tjera;
23. Përgjegjësia civile, penale dhe administrative, sigurimi i detyrueshëm dhe sigurimet e tjera ligjore të mjetit;
24. Kufizimi i konsumit; respektimi i mjedisit; ndotja atmosferike, akustike dhe nga hedhjet e mbeturinave;
25. Elementet përbërëse të mjetit, rëndësia e tyre për sigurinë: mirëmbajtja dhe përdorimi; stabiliteti i mjetit në lëvizje; sjellja e kujdesshme në qarkullim.
Provimi i informatizuar
Testi përbëhet nga 40 (dyzet) pyetje të pavarura, dy pyetje për çdo temë të rëndësishme dhe një pyetje për çdo temë tjetër, të cilat bien në mënyrë rastësore.
Koha – 40 (dyzet) minuta
Gabimet e lejuara - 4 (katër)
Temat për kategoritë C1, C
1. Periudha e drejtimit dhe pushimit. Rregullat për kohën (orët) e drejtimit të mjetit dhe periudhat e pushimit;
2. Pajisja regjistruese (tahografi). Përdorimi i pajisjeve të regjistrimit;
3. Legjislacioni për transportin e mallrave;
4. Dokumentet e mjetit dhe qarkullimit që kërkohen për transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave;
5. Sjellja në rastet e aksidenteve. Njohja e masave që duhet të merren pas një aksidenti ose dukuri të ngjashme, duke përfshirë veprime emergjente si evakuimi i udhëtarëve dhe njohuritë bazë për dhënien e ndihmës së parë;
6. Masat që merren për heqjen dhe zëvendësimin e rrotave;
7. Rregulla për peshat dhe dimensionet e automjeteve në qarkullim. Rregulla mbi kufijtë e shpejtësisë së këtyre mjeteve;



8. Kufizimet e fushëpamjes në varësi të karakteristikave të mjeteve. Leximi i një harte rrugore, planifikimi i itinerarit, përfshirë përdorimin e sistemeve elektronike të navigimit (fakultativ);

9. Sigurimi i ngarkesave në mjet. Kontrolli i ngarkesës (sistemimi dhe fiksimi), vështirësitë me ngarkesa të llojeve të ndryshme (p.sh., ngarkesa të lëngshme, ngarkesa të varura), ngarkimi dhe shkarkimi i mallrave dhe përdorimi i pajisjeve të ngarkimit;

10. Lidhja e rimorkiove dhe gjysmërimorkiove. Njohuri mbi llojet, ndërtimi, pjesët kryesore, lidhja, përdorimi dhe mirëmbajtja e përditshme e sistemeve lidhëse;

11. Ndërtimi dhe funksionimi i motorëve me djegie të brendshme, lëngjet (p.sh., vaji i motorit, lëngu ftohës), sistemi i ushqimit, sistemi elektrik, sistemi i ndezjes, sistemet e transmetimit të lëvizjes (friksoni, kutia e shpejtësisë etj.);

12. Sistemi i lubrifikimit dhe sistemi i ftohjes. Mbrojtja nga ngrica;

13. Njohuri mbi montimin, përdorimin e drejtë dhe kujdesin për gomat dhe sistemin e amortizimit;

14. Funksionimi i sistemit të frenimit dhe drejtimit. Njohuri mbi llojet, ndërtimin, pjesët kryesore. Mirëmbajtja e përditshme e sistemeve. Rregullatori i shpejtësisë (bllokazhi), dhe funksionimi i sistemit kundër bllokimit frenave (ABS);

15. Defektet dhe përcaktimi i shkakut të avarive;

16. Mirëmbajtja e mjeteve dhe riparimet e zakonshme;

17. Përgjegjësia e drejtuesit të mjetit në lidhje me marrjen në dorëzim të mallit, transportin dhe shpërndarjen e tij në përputhje me kushtet e rëna dakord midis palëve.

Provimi i informatizuar

Testi përbëhet nga 40 (dyzet) pyetje të pavarura, të cilat bien në mënyrë rastësore, dy pyetje për çdo temë dhe gjashtë pyetje nga gjashtë tema të ndryshme.

Koha – 40 (dyzet) minuta.

Gabimet e lejuara – 4 (katër).

Temat për kategoritë D1, D

1. Legjislacioni për transportin e udhëtarëve;

2. Përgjegjshmëria ndaj udhëtarëve që transportohen:

- kontrollet e nevojshme përpara udhëtimit;

- komoditeti (rehatia) dhe siguria e pasagjerëve;

- transporti i fëmijëve.

Provimi i informatizuar

Testi përbëhet nga 10 (dhjetë) pyetje të pavarura, pesë pyetje për çdo temë, të cilat bien në mënyrë rastësore.

Koha – 10 (dhjetë) minuta.

Gabimet e lejuara – 1 (një).

Lidhja 4

PROGRAMI I PËRGATITJES SË AFTËSIVE DREJTUESE DHE TË SJELLJES, KOHËZGJATJA E NEVOJSHME DHE PROVIMI

[Programi dhe prova e praktikës për lejedrejtimi të kategorisë A1, A2 dhe A]

I. Përgatitje dhe kontrolli teknik i motomjetit me qëllim sigurinë rrugore

Kandidati duhet të tregojë se është i aftë për t'u përgatitur për të drejtuar me siguri, duke kryer:

1. Rregullimin e veshjeve mbrojtëse si dorezat, çizmet dhe kaskën e sigurisë;

2. Kontrollin e rastit të gjendjes së gomave, frenave, sistemit të drejtimit, çelësit të ndaljes së emergjencës (nëse aplikohet), zinxhirëve, nivelit të vajit, stopeve, fenerëve, treguesve të drejtimit (sinjalet) dhe borisë.

II. Manovrat e veçanta

1. Mbajtja e motorit pa mbështetëse dhe lëvizja me të pa ndihmën e fuqisë motorike, duke ecur bashkë me motorin;



2. Parkimi i motorit mbi mbështetëset e tij;

3. Realizimi i dy manovrave me shpejtësi të ngadaltë, duke përfshirë një lëvizje zigzage. Kjo vlerëson manovrimin në friksion, frenim, ekuilibrim, drejtim, shikimin përpara, pozicionin në motor, si dhe pozicionin e këmbëve në mbështetësen e pushimit;

4. Realizimi i dy manovrave me shpejtësi të lartë, nga të cilat një manovër në marrsh të dytë apo të tretë, me shpejtësi të paktën 30 km/orë, si dhe një manovër, duke shmangur një pengesë, me shpejtësi minimale prej 50 km/orë.

Kjo mundëson vlerësimin e pozicionit në motor, drejtimin e shikimit, ekuilibrin, teknikën e drejtimit dhe teknikën e ndërrimit të marsheve;

5. Frenimi; bëhen të paktën dy ushtrime frenimi, duke përfshirë një frenim emergjence, me një shpejtësi minimale prej 50 km/orë.

Kjo mundëson vlerësimin në trajtimin e frenave para e pas frenimit, drejtimin e shikimit dhe pozicionin në motor.

III. Sjellja në trafik

Kandidati duhet të kryejë veprimet e mëposhtme, në situatat e trafikut normal, me siguri të plotë dhe duke marrë të gjitha masat e nevojshme në:

1. Drejtimin e mjetit: pas parkimit, pas ndalimit në trafik, hyrja në rrugë me përparësi;

2. Drejtimin e mjetit në rrugë të drejtë gjatë këmbimit me mjete të tjera (duke përfshirë dhe këmbimin në hapësira të kufizuara);

3. Drejtimin e mjetit në kthesa;

4. Kryqëzime: afrimi dhe kalimi i kryqëzimeve në nivel dhe disnivel;

5. Ndryshimin e drejtimit: kthimet majtas, djathtas dhe ndryshimi i korsive;

6. Hyrje-daljet në autostrada ose rrugë të ngjashme me to (nëse ka): hyrja nëpërmjet korsisë së shpejtimit, dalja nëpërmjet korsisë së ngadalësimit;

7. Parakalim: parakalimi i mjeteve të tjera (nëse është e mundshme), drejtimi i mjetit përgjatë pengesave (p.sh., mjeteve të parkuara) dhe parakalimi nga mjete të tjera (nëse është e përshtatshme);

8. Rrugë me karakteristika të veçanta (nëse ka): rrethrotullime, kalimet në nivel, vendqëndrime tramvaj/autobus, vendkalimet për këmbësorë, lëvizja me mjet në rrugë të përpjetë/tatëpjetë në distanca të gjata;

9. Marrjen e masave të nevojshme kur zbritet nga mjete.

Programi dhe prova e praktikës për lejedrejtimi të kategorisë B1 dhe B

Programi i përgatitjes mësimore në praktikë është sipas nenit 19.

Për kategorinë B, përveç programit, kandidatët duhet të kryejnë edhe 6 orë ushtrim të detyrueshëm praktike si më poshtë:

- 2 orë lëvizje në kushte të natës, në rrugë urbane të ngushta dhe të gjera ku ka mjete të parkuara anash ose jo, në kryqëzime të rregulluara me sinjale vertikale dhe impiante semaforike;

- 2 orë lëvizje në rrugë urbane ose në rrugë interurbane dytësore, duke shfrytëzuar mjetin në regjime të ndryshme të punës së motorit, në regjimin e momentit përdredhës maksimal dhe duke shfrytëzuar konsumin minimal të karburantit;

- 2 orë lëvizje në autostradë ose rrugë interurbane kryesore apo dytësore duke e kaluar shpejtësinë 50 km/orë, duke përdorur 5 marshe dhe marshin më të përshtatshëm të shpejtësisë gjatë lëvizjes.

I. Përgatitja dhe kontrolli teknik i automjetit me qëllim sigurinë rrugore

Kandidati duhet të tregojë se është i aftë për t'u përgatitur për të drejtuar mjetin me siguri, duke kryer:

1. Rregullimin e ndenjësës për të marrë një pozicion ulur të rregullt;

2. Rregullimin e pasqyrave, rripave të sigurimit dhe mbështetëses së kokës, nëse ka;

3. Kontrollin e dyerve, nëse janë të mbyllura;

4. Kontrollin e zakonshëm të gjendjes së gomave, sistemit të drejtimit, sistemit të frenimit të lëngjeve (p.sh., vaj motori, lëngu ftohës, lëngjet larëse), stopeve, fenerëve, treguesve të drejtimit dhe borisë.

II. Manovra të veçanta për t'u testuar



Një përzgjedhje e manovrave të mëposhtme do të testohen (të paktën dy manovrat për të katër pikat, duke përfshirë edhe një në marshin e lëvizjes prapa):

1. Lëvizja prapa në vijë të drejtë ose lëvizje prapa nga e majta apo nga e djathta në një kthesë duke qëndruar brenda korsisë;
2. Kthimi i mjetit në sens të kundërt, duke përdorur marshet para dhe prapa;
3. Parkimi i mjetit duke lënë hapësirë të nevojshme (paralel, pingul apo me kënd në lidhje me aksin e karrexhatës, para ose prapa një mjete, në vend të sheshtë, në të përpjetë ose tatëpjetë);
4. Frenim i përshtatshëm për ndalim të plotë. Kryerja e një ndalese emergjente është fakultative.

III. Sjellja në trafik

Kandidati duhet të kryejë të gjitha veprimet e mëposhtme në situatë të trafikut normal, në siguri të plotë dhe duke marrë të gjitha masat e nevojshme në:

1. Drejtimin e mjetit: pas parkimit; pas një ndalese në trafik; hyrjes në rrugë me përparësi;
2. Drejtimin e mjetit në rrugë të drejtë gjatë këmbimit me mjete të tjera (duke përfshirë edhe këmbimin në hapësira të kufizuara);
3. Drejtimin e mjetit në kthesa;
4. Kryqëzime: afrimi dhe kalimi i kryqëzimeve në nivel dhe disnivel;
5. Ndryshimin e drejtimit: kthimet majtas, djathtas dhe ndryshimi i korsive;
6. Hyrje-daljet në autostrada ose rrugë të ngjashme me to (nëse ka): hyrja nëpërmjet korsisë së shpejtimit; dalja nëpërmjet korsisë së ngadalësimit;
7. Parakalimi: parakalim i mjeteve të tjera (nëse është e mundur); drejtimin e mjetit përgjatë pengesave (p.sh., mjete të parkuara) dhe parakalimi nga mjete të tjera nëse është e përshtatshme);
8. Rrugë me karakteristika të veçanta (nëse ka): rrethrotullime; kalimet në nivel; vendqëndrime tramvaj/autobus; vendkalimet për këmbësorë; lëvizja me mjet në rrugë të përpjetë/tatëpjetë në distanca të gjata;
9. Marrjen e masave të nevojshme kur zbritet nga mjete.

Programi dhe prova e praktikës për lejedrejtimi të kategorisë BE, B me kodin 96

I. Përgatitja dhe kontrolli teknik i automjetit me qëllim sigurinë rrugore

Kandidati duhet të tregojë se është i aftë për t'u përgatitur dhe për të drejtuar mjetin me siguri, duke kryer:

1. Rregullimin e ndenjësës për të marrë një pozicion ulur të rregullt;
2. Rregullimin e pasqyrave, rripave të sigurimit dhe mbështetësës së kokës, nëse ka;
3. Kontrollin e dymve nëse janë të mbyllura;
4. Kontrollin e zakonshëm të gjendjes së gomave, sistemit të drejtimit, sistemit të frenimit, të lëngjeve (p.sh., vaj motori, lëngu ftohës, lëngjeve larëse), stopeve, fenerëve, treguesve të drejtimit dhe borisë;
5. Kontrollin e faktorëve të sigurisë që lidhen me ngarkimin e automjetit: trupi (karrocieria e hapur e mbyllur), dyert, mbyllja e kabinës, vendosja e ngarkesës, sigurimi i ngarkesës;
6. Kontrollin e mekanizmit bashkues dhe i lidhjeve elektrike e të frenimit;

II. Manovra të veçanta për t'u testuar

1. Bashkimi dhe shkëputja, ose shkëputja dhe ribashkimi i një rimorkio me mjetin e tij. Manovra duhet të përfshijë parkimin e mjetit pranë rimorkios (d.m.th., jo në rresht);
2. Kthimi prapa në një kthesë;
3. Parkim i sigurt për ngarkim/shkarkim.

III. Sjellja në trafik

Kandidati duhet të kryejë të gjitha veprimet e mëposhtme në situatë të trafikut normal, në siguri të plotë dhe duke marrë të gjitha masat e nevojshme, në:

1. Drejtimin e mjetit: pas parkimit; pas një ndalese në trafik; hyrjes në rrugë me përparësi;
2. Drejtimin e mjetit në rrugë të drejtë gjatë këmbimit me mjete të tjera (duke përfshirë edhe këmbimin në hapësira të kufizuara);
3. Drejtimin e mjetit në kthesa;



4. Kryqëzime: afrimi dhe kalimi i kryqëzimeve në nivel dhe disnivel;
 5. Ndryshimin e drejtimit: kthimet majtas dhe djathtas dhe ndryshimi i korsive;
 6. Hyrje-daljet në autostrada ose rrugë të ngjashme me to (nëse ka): hyrja nëpërmjet korsisë së shpejtimit; dalja nëpërmjet korsisë së ngadalësimit;
 7. Parakalim: parakalim i mjeteve të tjera (nëse është e mundur); drejtimin e mjetit përgjatë pengesave (p.sh. mjete të parkuara dhe parakalimi nga mjete të tjera nëse është e përshtatshme);
 8. Rrugë me karakteristika të veçanta (nëse ka): rrethrotullime; kalimet në nivel; vendqëndrime tramvaj/autobus; vendkalimet për këmbësorë; lëvizja me mjet në rrugë të përpjetë/tatëpjetë në distanca të gjata;
 9. Marrjen e masave të nevojshme kur zbritet nga mjeti.
- Programi dhe prova e praktikës për lejedrejtimi të kategorisë C1 dhe C
- I. Përgatitja dhe kontrolli teknik i mjetit me qëllim sigurinë rrugore
- Kandidati duhet të tregojë se është i aftë për t'u përgatitur për të drejtuar me siguri, duke kryer:
1. Rregullimin e ndenjësës për të marrë një pozicion ulur të rregullt;
 2. Rregullimin e pasqyrave, rripave të sigurimit dhe mbështetësës së kokës, nëse ka;
 3. Kontrollin e zakonshëm mbi gjendjen e gomave, timonit, frenave, stopeve, fenerëve, sinjaleve dhe borisë;
 4. Kontrollin e efektshmërisë së frenave dhe sistemit të drejtimit, kontrollin e gjendjes së rrotave, dadiçekëve, xhamave, dritareve dhe fshirësive, lëngjeve (p.sh. vaj motori, ujë antifriz, lëngjeve larëse), kontrolli i pajisjeve të kroskotit, përfshirë tahografin;
 5. Kontrollin e presionit të ajrit, depozitave të ajrit dhe ndalimi i rrjedhjes;
 6. Kontrollin e faktorëve të sigurisë që lidhen me ngarkimin e mjetit: mbulesa, mekanizmi i ngarkimit (nëse ka), mbyllje e kabinës (nëse ka), vendosja e ngarkesës, sigurimi i ngarkesës;
 7. Leximin e një hartë rruge, planifikimin e itinerarit të lëvizjes, duke përfshirë përdorimin e sistemeve elektronike të navigimit (fakultative).
- II. Manovra të veçanta që duhet të testohen
1. Kthimi prapa përgjatë një kthese;
 2. Parkimi i sigurt për ngarkim/shkarkimin në një rampë/platformë ose instalime të ngjashme.
- III. Sjellja në trafik
- Kandidati duhet të kryejë veprimet e mëposhtme, në situatat e trafikut normal, me siguri të plotë dhe duke marrë të gjitha masat e nevojshme në,
1. Drejtimin e mjetit: pas parkimit, pas ndalimit në trafik, hyrja në rrugë me përparësi;
 2. Drejtimin e mjetit në rrugë të drejtë gjatë këmbimit me mjete të tjera (duke përfshirë dhe këmbimin në hapësira të kufizuara);
 3. Drejtimin e mjetit në kthesa;
 4. Kryqëzime: afrimi dhe kalimi i kryqëzimeve në nivel dhe disnivel;
 5. Ndryshimin e drejtimit: kthimet majtas, djathtas dhe ndryshimi i korsive;
 6. Hyrje-daljet në autostrada ose rrugë të ngjashme me to (nëse ka): hyrja nëpërmjet korsisë së shpejtimit; dalja nëpërmjet korsisë së ngadalësimit;
 7. Parakalim: parakalimi i mjeteve të tjera (nëse është e mundshme), drejtim i mjetit përgjatë pengesave (p.sh., mjeteve të parkuara) dhe parakalimi nga mjete të tjera (nëse është e përshtatshme);
 8. Rrugë me karakteristika të veçanta (nëse ka): rrethrotullime; kalimet në nivel; vendqëndrime tramvaj/autobus; vendkalimet për këmbësorë; lëvizja me mjet në rrugë të përpjetë/tatëpjetë në distanca të gjata;
 9. Marrjen e masave të nevojshme kur zbritet nga mjeti.
- IV. Drejtim i sigurt i mjetit dhe drejtimi nga pikëpamja e energjisë
- Drejtim i mjetit në mënyrë të tillë që të garantojë sigurinë dhe zvogëlimin e konsumit të karburantit e të ndotjes, gjatë ngadalësimit të shpejtësisë, gjatë lëvizjes në të përpjetë e tatëpjetë. Zgjedhja e duhur e marshit.
- Programi dhe prova e praktikës për lejedrejtimi të kategorisë C1E dhe CE



I. Përgatitja dhe kontrolli teknik i mjetit me qëllim sigurinë rrugore

Kandidati duhet të tregojë se është i aftë për t'u përgatitur për të drejtuar me siguri, duke kryer:

1. Rregullimin e ndenjësës për të marrë një pozicion ulur të rregullt;
2. Rregullimin e pasqyrave, rripave të sigurimit dhe mbështetëses së kokës, nëse ka;
3. Kontrollin e zakonshëm mbi gjendjen e gomave, timonit, frenave, stopeve, fenerëve, sinjaleve dhe borisë;

4. Kontrollin e efektshmërisë së frenave dhe sistemit të drejtimit, kontrollin e gjendjes së rrotave, dadiçekëve, xhamave, dritareve dhe fshirëve, lëngjeve (p.sh., vaj motori, ujë antifriz, lëngjeve larëse), kontrolli i pajisjeve të kroskotit, përfshirë tahografin;

5. Kontrollin e presionit të ajrit, depozitave të ajrit dhe ndalimi i rrjedhjes;

6. Kontrollin e faktorëve të sigurisë që lidhen me ngarkimin e mjetit: mbulesa, mekanizmi i ngarkimit (nëse ka), mbyllje e kabinës (nëse ka), vendosja e ngarkesës, sigurimi i ngarkesës;

7. Kontrollin e mekanizmit bashkues dhe të lidhjeve elektrike e të frenimit;

8. Leximin e një hartë rruge, planifikimin e itinerarit të lëvizjes, duke përfshirë përdorimin e sistemeve elektronike të navigimit (fakultative).

II. Manovrat e veçanta që duhet të testohen

1. Bashkimi dhe shkëputja, ose shkëputja dhe ribashkimi i një rimorkio me mjetin e tij. Manovra duhet të përfshijë parkimin e mjetit pranë rimorkios (d.m.th. jo në një rresht);

2. Kthimi prapa përgjatë një kthese;

3. Parkimi i sigurt për ngarkim/shkarkimin në një rampë/platformë ose instalime të ngjashme.

III. Sjellja në trafik

Kandidati duhet të kryejë veprimet e mëposhtme, në situatat e trafikut normal, me siguri të plotë dhe duke marrë të gjitha masat e nevojshme në,

1. Drejtimin e mjetit: pas parkimit, pas ndalimit në trafik, hyrja në rrugë me përparësi;

2. Drejtimin e mjetit në rrugë të drejtë gjatë këmbimit me mjete të tjera (duke përfshirë dhe këmbimin në hapësira të kufizuara);

3. Drejtimin e mjetit në kthesa;

4. Kryqëzime: afrimi dhe kalimi i kryqëzimeve në nivel dhe disnivel;

5. Ndryshimin e drejtimit: kthimet majtas, djathtas dhe ndryshimi i korsive;

6. hyrje-daljet në autostrada ose rrugë të ngjashme me to (nëse ka): hyrja nëpërmjet korsisë së shpejtimit; dalja nëpërmjet korsisë së ngadalësimit;

7. Parakalim: parakalimi i mjeteve të tjera (nëse është e mundshme), drejtim i mjetit përgjatë pengesave (p.sh., mjeteve të parkuara) dhe parakalimi nga mjete të tjera (në se është e përshtatshme);

8. Rrugë me karakteristika të veçanta (nëse ka): rrethrotullime; kalimet në nivel; vendqëndrime tramvaj/autobus; vendkalimet për këmbësorë; lëvizja me mjet në rrugë të përpjetë/tatëpjetë në distanca të gjata;

9. Marrjen e masave të nevojshme kur zbritet nga mjete.

IV. Drejtim i sigurt i mjetit dhe drejtimi nga pikëpamja e energjisë

Drejtim i mjetit në mënyrë të tillë që të garantojë sigurinë dhe zvogëlimin e konsumit të karburantit e të ndotjes, gjatë ngadalësimit të shpejtësisë, gjatë lëvizjes në të përpjetë e tatëpjetë. Zgjedhja e duhur e marshit.

Programi dhe prova e praktikës për lejedrejtimi të kategorisë D1 dhe D

I. Përgatitja dhe kontrolli teknik i mjetit me qëllim sigurinë rrugore

Kandidati duhet të tregojë se është i aftë për t'u përgatitur për të drejtuar me siguri, duke kryer:

1. Rregullimin e ndenjësës për të marrë një pozicion ulur të rregullt;

2. Rregullimin e pasqyrave, rripave të sigurimit dhe mbështetëses së kokës, nëse ka;

3. Kontrollin e zakonshëm mbi gjendjen e gomave, timonit, frenave, stopeve, fenerëve, sinjaleve dhe borisë;



4. Kontrollin e efektshmërisë së frenave dhe sistemit të drejtimit; kontrollin e gjendjes së rrotave, dadiçekëve, xhamave, dritareve dhe fshirëseve, lëngjeve (p.sh., vaj motori, ujë antifriz, lëngjeve larëse), kontrollin e pajisjeve duke përfshirë tahografin;

5. Kontrollin e presionit të ajrit, depozitave të ajrit dhe ndalimi i rrjedhjes;

6. Marrjen e masave të veçanta të sigurisë për mjetin, për kontrollin e mjetit, dyert e shërbimit, daljet e emergjencës, pajisjen e ndihmës së shpejtë, aparatet zjarrfikëse dhe pajisje të tjera të sigurisë;

7. Leximin e një hartë rruge, planifikimin e itinerarit të lëvizjes, duke përfshirë përdorimin e sistemeve elektronike të navigimit (fakultative).

II. Manovra të veçanta që duhet të testohen me qëllim sigurinë rrugore

1. Kthimi prapa përgjatë një kthese;

2. Qëndrimi për hipjen dhe zbritjen e pasagjerëve në autobus në mënyrë të sigurt.

III. Sjellja në trafik

Kandidati duhet të kryejë veprimet e mëposhtme, në situatat e trafikut normal, me siguri të plotë dhe duke marrë të gjitha masat e nevojshme në,

1. Drejtimin e mjetit: pas parkimit, pas ndalimit në trafik, hyrja në rrugë me përparësi;

2. Drejtimin e mjetit në rrugë të drejtë gjatë këmbimit me mjete të tjera (duke përfshirë edhe këmbimin në hapësira të kufizuara);

3. Drejtimin e mjetit në kthesa;

4. Kryqëzime: afrimi dhe kalimi i kryqëzimeve në nivel dhe disnivel;

5. Ndryshimin e drejtimit: kthimet majtas, djathtas dhe ndryshimi i korsive;

6. Hyrje-daljet në autostrada ose rrugë të ngjashme me to (nëse ka): hyrja nëpërmjet korsisë së shpejtimit; dalja nëpërmjet korsisë së ngadalësimit;

7. Parakalim: parakalimi i mjeteve të tjera (nëse është e mundshme), drejtimi i mjetit përgjatë pengesave (p.sh. mjeteve të parkuara) dhe parakalimi nga mjete të tjera (nëse është e përshtatshme);

8. Rrugë me karakteristika të veçanta (nëse ka): rrethrotullime, kalimet në nivel, vendqëndrime tramvaj/autobus, vendkalimet për këmbësorë, lëvizja me mjet në rrugë të përpjetë/tatëpjetë në distanca të gjata;

9. Marrjen e masave të nevojshme kur zbritet nga mjete.

IV. Drejtimit i sigurt i mjetit dhe drejtimit nga pikëpamja e energjisë

Drejtim i mjetit në mënyrë të tillë që të garantojë sigurinë dhe zvogëlimin e konsumit të karburantit e të ndotjes, gjatë ngadalësimit të shpejtësisë, gjatë lëvizjes në të përpjetë e tatëpjetë. Zgjedhja e duhur e marshit.

Programi dhe prova e praktikës për lejedrejtimi të kategorisë D1E dhe DE

I. Përgatitja dhe kontrolli teknik i mjetit me qëllim sigurinë rrugore

Kandidati duhet të tregojë se është i aftë për t'u përgatitur për të drejtuar me siguri, duke kryer:

1. Rregullimin e ndenjësës për të marrë një pozicion ulur të rregullt;

2. Rregullimin e pasqyrave, rripave të sigurimit dhe mbështetëses së kokës, nëse ka;

3. Kontrollin e zakonshëm mbi gjendjen e gomave, timonit, frenave, stopeve, fenerëve, sinjaleve dhe borisë;

4. Kontrollin e efektshmërisë së frenave dhe sistemit të drejtimit; kontrollin e gjendjes së rrotave, dadiçekëve, xhamave, dritareve dhe fshirëseve, lëngjeve (p.sh. vaj motori, ujë antifriz, lëngjeve larëse), kontrollin e pajisjeve duke përfshirë tahografin;

5. Kontrollin e presionit të ajrit, depozitave të ajrit dhe ndalimi i rrjedhjes;

6. Marrjen e masave të veçanta të sigurisë për mjetin, për kontrollin e mjetit, dyert e shërbimit, daljet e emergjencës, pajisjen e ndihmës së shpejtë, aparatet zjarrfikëse dhe pajisje të tjera të sigurisë;

7. Kontrollin e mekanizmit bashkues të frenave dhe të lidhjeve elektrike;

8. Leximin e një hartë rruge, planifikimin e itinerarit të lëvizjes, duke përfshirë përdorimin e sistemeve elektronike të navigimit (fakultative).

II. Manovrat e veçanta që duhet të testohen

1. Bashkimi dhe shkëputja, ose shkëputja dhe ribashkimi i një rimorkio me mjetin e tij. Manovra duhet të përfshijë parkimin e mjetit pranë rimorkios (d.m.th. jo në një rresht);

2. Kthimi prapa përgjatë një kthese;

3. qëndrim për hipjen dhe zbritjen e pasagjerëve në autobus në mënyrë të sigurt.

III. Sjellja në trafik

Kandidati duhet të kryejë veprimet e mëposhtme, në situatat e trafikut normal, me siguri të plotë dhe duke marrë të gjitha masat e nevojshme në:

1. Drejtimin e mjetit: pas parkimit, pas ndalimit në trafik, hyrja në rrugë me përparësi;

2. Drejtimin e mjetit në rrugë të drejtë gjatë këmbimit me mjete të tjera (duke përfshirë edhe këmbimin në hapësira të kufizuara);

3. Drejtimin e mjetit në kthesa;

4. Kryqëzime: afrimi dhe kalimi i kryqëzimeve në nivel dhe disnivel;

5. Ndryshimin e drejtimit: kthimet majtas, djathtas dhe ndryshimi i korsive;

6. Hyrje-daljet në autostrada ose rrugë të ngjashme me to (nëse ka): hyrja nëpërmjet korsisë së shpejtimit; dalja nëpërmjet korsisë së ngadalësimit;

7. Parakalim: parakalimi i mjeteve të tjera (nëse është e mundshme), drejtimi i mjetit përgjatë pengesave (p.sh., mjeteve të parkuara) dhe parakalimi nga mjete të tjera (nëse është e përshtatshme);

8. Rrugë me karakteristika të veçanta (nëse ka): rrethrotullime, kalimet në nivel, vendqëndrime tramvaj/autobus, vendkalimet për këmbësorë, lëvizja me mjet në rrugë të përpjetë/tatëpjetë në distanca të gjata;

9. Marrjen e masave të nevojshme kur zbritet nga mjete.


IV. Drejtim i sigurt i mjetit dhe drejtimi nga pikëpamja e energjisë

Drejtim i mjetit në mënyrë të tillë që të garantojë sigurinë dhe zvogëlimin e konsumit të karburantit e të ndotjes, gjatë ngadalësimit të shpejtësisë, gjatë lëvizjes në të përpjetë e tatëpjetë. Zgjedhja e duhur e marshit.

Lidhja 4/1

MANOVRAT E VEÇANTA PËR PROVËN E PRAKTIKËS PËR LEJEDREJTIMET E KATEGORIVE A1, A2, A

Prova e ekuilibrit me lëvizje të ngadalësuar



Faza e parë:

Lëvizje me motor brenda një korridorit me gjerësi 2.2 m ndërmjet 5 koneve prej gome ose plastike, të vendosur në një vijë të drejtë me distancë:

- 4 m nga njëri-tjetri, për testin e aftësive dhe sjelljes për lejedrejtimi të kategorisë A1;


- 4.5 m nga njëri-tjetri, për testin e aftësive dhe sjelljes për lejedrejtimi të kategorisë A2 dhe A.

Faza e dytë:

Lëvizja me motor brenda 5 koneve të vendosur në një rreth me qendër 8 m larg nga koni i 5 i korridorit gjatësor dhe me rreze:

- 3.5 m, për testin e aftësive dhe sjelljes për të marrë lejedrejtimi të kategorisë A1;
- 4.5 m, për testin e aftësive dhe sjelljes për të marrë lejedrejtimi të kategorisë A2 dhe A.

2. Prova në një korridor të ngushtë



për A1: $X = 1,10$ m

për A2-A: $X = 1,30$ m

Lëvizja në një korridor me gjatësi 45 m dhe gjerësi:


- 1.10 m për lejedrejtimi të kategorisë A1;
- 1.30 m për lejedrejtimi të kategorive A2-A.

15 m e parë, ku arrihet shpejtësia e nevojshme, janë me vija horizontale.

Në 30 m e tjerë janë vendosur në të dyja anët kone prej gome plastike në një distancë 1 m nga njëri-tjetri.

Kandidati duhet të kalojë nëpër korridorin që kufizohet nga kone (30 m) me një shpejtësi prej së paku 30 km/orë.

3. Prova e kalimit të një pengese




për A1: $X = 60$ m, $Y = 6$ m, $Z = 4,5$ m për A2-A: $X = 44$ m, $Y = 7$ m, $Z = 4,5$ m

Ndërtohet një korridor me gjerësi 1.1 m, gjatësi 60 m për lejedrejtimi të kategorisë A1 dhe gjerësi 1.1 m, gjatësi 44 m për lejedrejtimi të kategorive A2-A. Vendosen 2 kone 15 m larg nga drejtkëndëshi i jashtëm i pengesës me dimensione 4.5 m x 6 m për lejedrejtimi të kategorisë A1 dhe 4.5 m x 7 m për lejedrejtimi të kategorisë A2-A. Në drejtkëndëshin e jashtëm janë vendosur 4 kone në kulme dhe 4 kone në korridoret e hyrjes dhe të daljes. Në qendër të drejtkëndëshit është një katror, me kone të vendosura në kulmet e tij, në distancë prej 1 m nga njëri-tjetri. Katrori përbën pengesën.

Kandidati lëviz përgjatë korridorit me shpejtësi 50 km/orë deri te 2 konet e para, rregullon shpejtësinë dhe lëviz djathtas ose majtas katrorit pa kaluar kufijtë e drejtkëndëshit dhe lëviz 5 m në korridorin e daljes.

4. Prova në frenim



për A1: $X = 60$ m

për A2-A: $X = 44$ m

Në fund të korridorit të gjerë 1 m dhe të gjatë 60 m për lejedrejtimi të kategorisë A1, 44 m për lejedrejtimi të kategorive A1 - A2 vendosen 4 kone në kulmet e katrorit me brinjë 1 m.

Në provën e parë kandidati lëviz me shpejtësi prej 30 km/orë dhe në provën e dytë 50 km/orë duke përdorur të dy frenat para dhe mbrapa. Ndalimi i mjetit duhet të realizohet brenda katrorit.

Lidhja 4/2

MANOVRAT E VEÇANTA PËR PROVËN E PRAKTIKËS PËR LEJEDREJTIMET E KATEGORIVE B1, B

1. Lëvizja dhe kontrolli i mjetit në kthesë




Figura 1

Vendosja e koneve bëhet sipas figurës 1:

Gjatësia e manovrimit: 18 m (13 + 5);

Gjerësia: 11 m;

Kandidati kalon konin e parë dhe te koni i dytë futet në kthesë, mbaron kthesën dhe vazhdon lëvizjen me shpejtësi konstante deri te koni i fundit.

2. Parkimi dhe lëvizja prapa




Figura 2

Gjatësia e zonës së manovrimit: 18/19 m

Gjerësia: 12 m

Përgatitja e testit siç tregohet në fig. 2

Kandidati, i nisur nga koni i parë, pasi përshkon një rrugë të drejtë rreth 10 m, kthehet majtas dhe e ndalon mjetin në brendësi të zonës së qëndrimit të kufizuar nga katër kone. Pastaj vendos marshin prapa (indietro) dhe kthehet djathtas duke lënë në të majtë të tij konin e fundit kufizues.

3. Frenimi me precizion




Figura 3

Gjatësia e zonës së manovrës është rreth 20 m.

Gjerësia e zonës së manovrës është 3 m.

Kandidati nis nga dy konet e parë kufizues dhe pas fazës së parë të përshpejtimit fillon të ftojë në mënyrë të tillë për të ndaluar mjetin në afërsi të dy koneve të vendosura në fund të hapësirës së shënuar. Mjeti duhet të ndalojë pranë vijës pa i prekur konet.

Lidhja 5

PROGRAMI ORIENTUES PËR KUALIFIKIMIN E MËSUESVE TË TEORISË NË AUTOSHKOLLA

Mësuesit e teorisë së autoshkollave japin mësim për përgatitjen teorike të kandidatëve që kërkojnë të pajisen me lejedrejtimi dhe për përgatitjen teorike të personave që kërkojnë të pajisen me Certifikatë të Aftësisë Profesionale.

Programi teorik orientues për kualifikimin e mësuesve të teorisë në autoshkollë është sipas lidhjes 3 dhe nenit 28, pika 2, të këtij udhëzimi dhe ai i përgatitjes së personave që kërkojnë të pajisen me Certifikatë të Aftësisë Profesionale që është përcaktuar në udhëzimin përkatës.

PROGRAMI ORIENTUES PËR KUALIFIKIMIN E INSTRUKTORËVE TË PRAKTIKËS NË AUTOSHKOLLA

1. Njohuri të plota sipas nenit 28, pika 2.
2. Njohuri të plota mbi standardet e sinjalizimit rrugor, si dhe përdorimi korrekt i tyre;
3. Njohuri të plota për zgjidhjen e situatave në kryqëzime;
4. Njohuri të plota mbi normat e sjelljes dhe aftësimi për zbatimin e tyre në praktikë;
5. Njohuri të përgjithshme për llojet e transportit dhe veçoritë e tyre.

Instruktorët e praktikës testohen sipas kategorisë së lejedrejtimit që ata përgatisin kandidatë.



Lidhja 6

PROGRAMI ORIENTUES PËR KUALIFIKIMIN E SPECIALISTËVE TË DPSHTRR-së

I. Legjislacioni rrugor

Kodi Rrugor me nënaktet ligjore në zbatim të tij.

II. Siguria rrugore

1. Njohuri për mjetin dhe pjesët përbërëse të tij duke u përqendruar në lidhjen 3.

2. Njohuri të plota sipas nenit 28, pika 2.

III. Transporti dhe administrimi i tij

1. Njohje e përgjithshme për ato pjesë nga Kodi Penal dhe Civil që trajtojnë problemet e qarkullimit dhe të transportit.

2. Njohuri mbi marrëveshjet kryesore ndërkombëtare në fushën e mjeteve motorike dhe të transportit me to, në veçanti, ato në të cilat aderon Shqipëria.

3. Njohja e plotë e ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore” dhe aktet në zbatim të tij dhe konkretisht:

a) transporti i udhëtarëve, kombëtar dhe ai ndërkombëtar;

b) transporti i mallrave, kombëtar dhe ai ndërkombëtar, llojet e tij;

c) përgjegjësitë, detyrimet dhe të drejtat e drejtuesve të mjeteve sipas llojit të transportit;

d) dokumentacioni i nevojshëm sipas llojit të transportit kombëtar dhe ndërkombëtar.

4. Transporti i mallrave të rrezikshme, llojet dhe dokumentacioni i nevojshëm për këtë lloj transporti, rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare.

5. Ngarkesa e mjetit sipas llojit të mallit, sasisë, vendosjes, përmasave gabarite etj., dhe efektet e saj.

6. Përdorimi i hartave rrugore dhe treguesit përkatës.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë